

# RAPORTI I ECRI PËR SHQIPËRİNË

  
**(cikli i katërt monitorues)**

Miratuar më 15 dhjetor 2009

Publikuar më 2 mars 2010

ECRI Secretariat  
Directorate General of Human Rights and Legal Affairs  
Council of Europe  
F-67075 STRASBOURG Cedex  
Tel.: + 33 (0) 388 41 29 64  
Fax: + 33 (0) 388 41 39 87  
E-Mail: combat.racism@coe.int

[www.coe.int/ecri](http://www.coe.int/ecri)

# RAPORTI I ECRI PËR SHQIPËRİNË

## (cikli i katërt monitorues)

Miratuar më 15 dhjetor 2009

Publikuar më 2 mars 2010

*Lutemi, vini re se ky dokument eshte një variant i perkthyer. Ne rast dyshimi,  
duhet t'i referoheni versionit origjinal ne Anglisht apo Frengjisht*



# PËRMBAJTJA

<b>HYRJE.....</b>	<b>7</b>
<b>PËRMBLEDHJE.....</b>	<b>9</b>
<b>I. EKZISTENCA DHE ZBATIMI I DISPOZITAVE LIGJORE .....</b>	<b>13</b>
INSTRUMENTET NDËRKOMBËTARE LIGJORE.....	13
DISPOZITAT KUSHTETUESE DHE DISPOZITAT TJERA THEMELORE .....	13
DISPOZITAT E LIGJIT ZGJEDHOR .....	14
DISPOZITA E LIGJIT PENAL KUNDËR RACIZMIT .....	15
DISPOZITAT E SË DREJTËS ADMINISTRATIVE DHE CIVILE.....	17
ADMINISTRIMI I DREJTËSISË.....	17
ORGANET ANTI-DISKRIMINUESE DHE INSTITUCIONET TJERA .....	18
- <i>OMBUDSMANI (AVOKATI I POPULLIT)</i> .....	18
- <i>KOMITETI SHTETËROR PËR MINORITETET</i> .....	20
<b>II. DISKRIMINIMI NË FUSA TË NDRYSHME.....</b>	<b>21</b>
STREHIMI .....	21
ARSIMI .....	23
- <i>PJESËMARRJA E FËMIJËVE ROMË DHE EGJIPTIANË</i> .....	23
PUNËSIMI .....	27
SHËNDETI.....	28
<b>III. DHUNA RACISTE .....</b>	<b>29</b>
<b>IV. RACIZMI NË DEBATIN PUBLIK.....</b>	<b>29</b>
QASJA NË MEDIA .....	30
<b>V. GRUPET E RREZIKUARA/SYNUARA .....</b>	<b>30</b>
ROMËT.....	30
- <i>REGJISTRIMI CIVIL</i> .....	30
- <i>IMPLEMENTIMI I STRATEGjisë KOMBËTARE PËR KUSHTET E JETESËS TË KOMUNITETIT ROMË</i> .....	31
EGJIPTIANËT SHQIPTARË .....	33
MINORITETET GREKE, MAQEDONASE, SËRBO-MALAZEZE DHE VLLAHË-ARUMUNË;	
KOMUNITETI BOSHNJAK.....	34
IMIGRUESIT, REFUGJATËT DHE AZIL KËRKUESIT .....	35
<b>VI. MARGJINALIZIMI DHE NEGLIZHIMI I ROMËVE DHE EGJIPTIANËVE.....</b>	<b>36</b>
<b>VII. PJESËMARRJA E MINORITETEVE NË JETËN PUBLIKE .....</b>	<b>37</b>
PJESËMARRJA NË VENDIM-MARRJE POLITIKE.....	37
PERFAQESIMI NE INSTITUCIONET SHTETERORE .....	38
KONSULTIMET DHE PËRFSHIRJA E PERSONAVE TË CILËT I TAKOJNË GRUPEVE MINORITARE .....	39
<b>VIII. TRAFIKIMI I FËMIJËVE ROMË DHE EGJIPTIAN.....</b>	<b>39</b>
<b>IX. SJELLJA E ZYRTARËVE PËR ZBATIMIN E LIGJIT .....</b>	<b>40</b>
<b>X. MONITORIMI I RACIZMIT DHE DISKRIMINIMI RACIAL.....</b>	<b>41</b>
REKOMANDIMET QË DO TË NDIQEN ME PËRPARËSI.....	43
<b>BIBLIOGRAFIA.....</b>	<b>45</b>
<b>SHTOJCË : KENDVESHTRIMI I QEVERISE .....</b>	<b>47</b>



## **HYRJE**

Komisioni Evropian kundër racizmit dhe jo tolerancës (ECRI) është themeluar nga Këshilli i Evropës. Është një organ i pavarur monitorimi i specializuar në çështjet lidhur me racizmin dhe jo tolerancën. Është i përbërë prej anëtarë të pavarur e të paanshëm që janë zgjedhur në bazë të autoritetit të tyre moral dhe përvojës se tyre të njojur në trajtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me racizmin, ksenofobinë, antisemitizmin dhe jo tolerancën.

Në kuadër të veprimitarive të tij statutore, ECRI kryen analiza monitoruese vend përvend, me të cilën analizon situatën në secilin nga shtetet anëtare lidhur me gjendjen e racizmit dhe jo tolerancës dhe harton sugjerime dhe propozime për trajtimin e problemeve të identifikuara.

Monitorimi i ECRI-it vend përvend bëhet në të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës në nivel të njëjtë. Kjo punë kryhet në bazë ciklesh prej vjetësh duke përfshirë nëntë/dhjetë vende në vit. Raportet e raundit të parë u përfunduan në fund të vitit 1998, ato të raundit të dytë në fund të vitit 2002 dhe ato të raundit të tretë në fund të vitit 2007. Puna për raportet e raundit të katërt filluan në janar 2008.

Metodat e punës përpunimin e raporteve përfshijnë analiza dokumentesh, një vizitë pune në vendin konkret dhe më pas një dialog konfidencial me autoritetet kombëtare.

Raportet e ECRI nuk janë rezultat anketimesh ose thjesht dëshmish, por rezultat analizash, bazuar mbi një numër të madh informacionesh nga burime të ndryshme. Studimet në bazë të dokumenteve mbështeten në një numër të madh burimesh të shkruara, kombëtare e ndërkombëtare. Vizita në vend bën të mundur takimin me grupe drejtpërdrejtë të interesuara (qeveritare dhe jo qeveritare) dhe mbledhjen e informacioneve të hollësishme. Dialogu konfidencial me autoritetet kombëtare u lejon këtyre të fundit të propozojnë, nëse e shohin të nevojshme, ndryshime në projekt-raport, për të korrigjuar gabime të mundshme faktike të përfshira në tekst. Në përfundim të këtij dialogu, autoritetet kombëtare mund të kërkojnë, nëse dëshirojnë, që mendimet e tyre të paraqiten si shtojcë e raportit përfundimtar të ECRI.

Raportet vend përvend të raundit të katërt fokusohen në zbatimin dhe vlerësim. Ato shqyrtojnë shtrirjen nëpër të cilën janë ndjekur rekomandimet kryesore të ECRI-it nga raportet e kaluara dhe përfshijnë vlerësimin e politikave të miratuarë dhe masat e ndërmarrë. Këto raporte gjithashtu përfshijnë edhe analizat e zhvillimeve të reja të shtetit në fjalë.

Zbatimi prioritar kërcohet për një numër rekomandimesh specifike të përzgjedhura nga raporti i ri i raundit të katërt. Jo më vonë se dy vjet, pas publikimit të këtij rapporti, ECRI do të kryejë një monitorim të këtyre rekomandimeve specifike.

**Raporti në vijim është hartuar nga ECRI nën përgjegjësinë e tij të plotë. Raporti paraqet gjendjen deri në datën 3 korrik 2009 dhe çdo zhvillim që ka ndodhur pas kësaj date nuk përfshihet në analizën që pason, e as nuk merret parasysh në konkluzionet dhe propozimin e parashtruar nga ECRI.**



## PËRMBLEDHJE

**Që nga botimi i raportit të tretë për Shqipërinë më 14 qershor 2005, është shënuar përparim në mjaft fusha që mbulohen nga ky raport.**

Një numër i madh i instrumenteve ndërkombëtare që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut dhe luftën kundër diskriminimit kanë hyrë në fuqi në Shqipëri.

Në fushën e ligjit penal, natyra raciste e një shkeljeje ose motivimi i urrejtjes së saj tanë përbën një rrëthanë rënduese specifike dhe është miratuar një përkufizim i ri i krimit të torturës. Tani më është ndaluar shpërndarja me mjete të kompjuterizuara të deklaratave raciste ose ksenofobie, kërcënimeve ose fyerjeve. Autoritetet kanë përforuar dispozitat e ligjit penal kundër trafikimit dhe kanë miratuar masat të cilat synojnë mbrojtjen më të madhe të viktimateve.

Janë bërë përpjekje edhe në përmirësimin e funksionimit të sistemit gjyqësor. Skemat e trajnimeve fillestare dhe vazhduese të ndryshme për anëtarët e gjyqësor dhe zyrtarët e policisë, ofrojnë përfshirje më të gjërë sistematike në çështjet e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Gjithashtu, janë shënuar shenja të përmirësimit lidhur me problemin e keqrajtimit nga ana e policisë.

Avokati i Popullit ka vazhduar konsolidimin e rolit që ai luan në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, në lidhje me parandalimin e torturës. Komiteti Shtetëror për Minoritetet ka konsoliduar gjithashtu përvojën e vet dhe i janë dhënë burime shtesë.

Janë miratuar masa të shumta me ndikim pozitiv në gjendjen e romëve. Këto masa kanë për qëllim, për shembull, përmirësimin e kushteve të banimit të tyre, veçanërisht nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës. Në fushën e arsimit ato janë projektuar, inter alia, për të përmirësuar kushtet materiale të arsimit shkollor, për të ndihmuar fëmijët romë që të kenë qasje në shkollim dhe për ta luftuar mosvijueshmërinë dhe braktisjen e shkollës. Romët mund të përfitojnë nga një varg trajnimesh profesionale dhe skemave udhëzuese; gjithashtu janë ndërmarrë masa edhe në përmirësimin e mundësive të romëve në kujdesin shëndetësor. Në vitin 2008, autoritetet shqiptare pengesat kryesore për regjistrimin e fëmijëve jashtë kohës së caktuar. Disa iniciativa interesante janë ndërmarrë gjithashtu edhe në nivelin vendor në disa nga këto fusha, edhe pse përpjekje të tillë mbenet mjaft të shpërndara dhe jo shumë të koordinuara.

Njësia përgjegjëse për monitorimin dhe Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetës së Komunitetit Rom ka organizuar fushata për informim dhe diskutime në tryesa të rrumbullakëta, si dhe ia ka dedikuar një pjesë të përpjekjeve të saj forcimit të kapaciteteve monitoruese të saj dhe përforcimit të kapaciteteve të shoqatave rome.

Lidhur me emigrantët, refugjatët dhe azil kërkuesit, në vitin 2006 autoritetet shqiptare morën përsipër përgjegjësinë për procedurat parakualifikuese të cilat synojnë identifikimin e personave në nevojë për ndihmë ndërkombëtare dhe mbrojtje menjëherë pas arritjes së tyre në kufi, si dhe duke iu referuar atyre sa më shpejt të jetë e mundur rreth procedurës së duhur. Trajnimi i është kushtuar zyrtarëve të emigracionit dhe policisë kufitare për të rritur ndërgjegjësimin e tyre për çështjet e të drejtave të njeriut.

Në vitin 2006 u miratua një Kod i Etikës për mediat audiovizive, duke përfshirë nevojën që të respektohen opinionet e të gjitha llojeve, duke kundërshtuar çdo formë të diskriminimit, si dhe u themelua Këshilli mbi Etikën e Mediave.

## **ECRI mirëpret këto zhvillime pozitive në Shqipëri. Megjithatë, pavarësisht nga progresi i arritur, disa çështje vazhdojnë të sjellin shqetësim.**

Nuk ka ende ndonjë ligj të përgjithshëm i cili ndalon diskriminimin ose ndonjë shembull të ndonjë vendimi në të cilën Gjykata Kushtetuese ka zbatuar parimet themelore të mosdiskriminimit; shpesh konkludohet se, meqenëse legjislacioni i shtetit parashev që të gjithë qytetarët të janë të barabartë, nuk ka diskriminim në shoqërinë shqiptare. Gjithashtu, nuk ka ndonjë organ në Shqipëri me përgjegjësi të shprehur për të luftuar diskriminimit racial.

Në fushën e ligjit zgjedhor, organizatat e shoqërisë civile shprehën shqetësimet para zgjedhjeve të përgjithshme të 28 qershor 2009 se dispozitat e reja që rregullojnë regjistrimin në listat zgjedhore mund të janë shumë kufizuese, dhe në këtë mënyrë i privojnë individët, në veçanti romët dhe egjiptianët shqiptarë nga e drejta për të votuar. Ndonëse janë ndërmarrë masa financiare për të mbuluar koston e regjistrimit të qytetarëve të pafavorizuar me të ardhura të kufizuara, duket se një numër i caktuar i qytetarëve të cilët nuk posedojnë pasaportë të vlefshme, nuk kanë bërë kërkesë për t'u regjistruar para zgjedhjeve, dhe procesi i regjistrimit civil është duke vazhduar.

Pavarësisht nga masat e ndërmarra, shumë romë dhe egjiptianë në Shqipëri janë përballur me varfëri ekstreme, dhe marginizim social dhe ekonomik. Shumë prej tyre jetojnë në kushte të pasigurta nëpër vendbanime të cilat nuk kanë mundësi për ujë të pijshëm, furnizim me energji elektrike, rrjete kanalizimi dhe nëpër zona me kujdes shëndetësor të kufizuari. Romët janë veçanërisht në rrezik për t'u dëbuar nga shtëpitë e tyre pa u risistemuar sistematikisht. Krahas kësaj, një numër jashtëzakonisht i madh në mesin e të rinjve të papunë romë duhet të luftojnë me diskriminim të drejtëdrejtë the fenomenin e "mosvijueshmërisë së fshehtë". Numri i fëmijëve romë të cilët ndjekin shkollën mbetet shumë më i ulët sesa shumica e popullsisë, dhe shumica e fëmijëve romë braktisin shkollën para kalimit të moshës minimale ligjore. Kjo gjithashtu i bën ata mjaft të ndjeshëm ndaj trafikimit. Megjithëse disa nga këto probleme janë të njëjtë për disa pjesë të tjera të popullisë shqiptare, romët dhe egjiptianët përfjetojnë situata të tillë në një masë jo proporcionale. Përveç kësaj, indiferencia ndaj këtyre komuniteteve e treguar nga politikanë të caktuar, sidomos në nivel vendor, dhe përfaqësimi i tyre i ulët në jetën politike dhe publike të vendit dhe mbulimi i kufizuari nga mediat shqiptare, përkëqësojnë marginizimin e tyre si dhe pengojnë zgjidhjen e problemeve me të cilat ata ballafaqohen.

Në lidhje me mbrojtjen dhe njohjen e minoritetave, disa përfaqësues të pakicave vazhdojnë të shprehin kritikat lidhur me efikasitetin e Komitetit Shtetëror për Minoritetet. Sipas përfaqësuesve vllah/arumune, pakicë etno-gjuhësore, dallimi në mes minoritetave "kombëtare" dhe "etno gjuhësore" sjell një ndjenjë të fortë për tu trajtuar si inferiorë. Komunitetet boshnjake dhe egjiptiane shprehin dëshirë që tu kushtohet më shumë vëmendje kërkeseve të tyre specifike.

Në çështjet e migracionit dhe azilit, nuk janë miratuar ende të gjitha instrumentet ligjore ose rregulatorët e nevojshëm për zbatimin e legjislacionit në fuqi në lidhje me kërkesat për azil, si dhe vërehet se qarkullimi i madh midis stafit përgjegjës për shqyrtimin e kërkeseve për azil dhe për zbatimin e efektshëm të para-procedurës ekzaminuese, nganjëherë ka penguar funksionimin e këtyre sistemave.

Nuk ka pasur përparim në drejtim të futjes së një sistemi të garantuar, ku të gjitha akuzat e keqtrajtimit nga policia do të janë subjekt i një hetimi të plotë nga një organ i pavarur.

Për shkak të mungesës së një sistemi të plotë, koherent të mbledhjes së të dhënave për qasje në të drejtat e grupeve minoritare të ndryshme të pranishme brenda vendit, ose në zbatimin e dispozitave të ligjit penal për racizmin, diskriminimin dhe jo

tolerancën, është vështirë për autoritetet të monitorojnë efektivitetin e masave të ndërmarra për të përmirësuar situatën e grupeve të caktuara.

**Në këtë raport, ECRI rekomandon që autoritetet Shqiptare të ndërmarrin masa në shumë zona; raporti bën një sërë rekomandimesh, duke përfshirë si në vijim.**

ECRI bën një numër rekomandimesh që synojnë sigurimin e miratimit të legjislacionit të plotë dhe zbatimin e plotë të dispozitave mbi luftimin e racizmit, diskriminimit dhe jo tolerancës, jo vetëm përsa i përket ligjit penal, ndihmës juridike dhe sjelljes së policisë, por gjithashtu edhe në lidhje me fushat e ligjit zgjedhor, migrimit dhe azilit. Në lidhje me këtë theksohet rëndësia e trajnimit dhe ngritja e masave të ndërgjegjësimit. ECRI gjithashtu rekomandon formimin e një organi të specializuar për luftimin kundër racizmit dhe diskriminimit racial.

ECRI përsërit rekomandimin e tij që autoritetet shqiptare të forcojnë kornizën ligjore në fushën e së drejtës civile dhe administrative duke futur legjislacionin e plotë në luftën kundër diskriminimit, të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, në të gjitha fushat kyçë të jetës. Në lidhje me këtë, ai i referohet Rekomandimit nr. 7 për Politikë të Përgjithshme mbi legjislacionin kombëtar për të luftuar racizmin dhe diskriminimin racial..

ECRI bën një sërë rekomandimesh që kanë për qëllim, së pari, rritjen e përpjekjeve për të luftuar format e ndryshme të diskriminimit që mund të jenë hasur nga Romët dhe Egjiptianët në Shqipëri, veçanërisht në fushën e strehimit, arsimit, mundësitetë në punësim, shëndetësi, regjistrimin civil dhe pjesëmarrjen në çështjet publike dhe, së dyti, në lehtësimin e zbatimit të plotë të Strategjisë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve Jetësore të Komunitetit Rom, duke përfshirë autoritetet vendore.

ECRI fuqimisht rekomandon që, në konsultim me komunitet përkatëse, autoritetet shqiptare të ecin përpara me zbatimin e masave konkrete, duke siguruar që çdo familje rome të ketë mundësi për strehim të mirë, vendbanimet rome të kenë mundësi për energji elektrike, ujë të pijshëm, kanalizime dhe rrjete rrugore. Në këtë drejtim, rekomandohet që autoritetet të rregullojnë qartazi objektivat dhe grupet që synojnë në këtë drejtim, për të paktën dy vitet e ardhshme dhe të publikojnë raporte të rregullta mbi progresin e bërë.

ECRI rekomandon që autoritetet shqiptare të përshtypojnë krijimin dhe të mbështesin funksionimin e objekteve parashkollore, duke u mundësuar fëmijëve romë të përmirësojnë aftësitë e tyre të gjuhës shqipe para se të hyjnë në shkolla fillore; gjithashtu i fton autoritetet shqiptare të mbështesin zbatimin e nismave joqeveritare të cilat kanë dhëne rezultate të mira në këtë fushë.

ECRI bën një numër rekomandimesh që synojnë përfshirjën më të madhe të grupeve pakicë dhe që garantojnë se situata e tyre do të merret më mirë në konsideratë. Ai rekomandon që autoritetet të përforcojnë dialogun e tyre me përfaqësuesit e minoriteteve vllahe / arumune, komunitetit boshnjak dhe Egjiptianët shqiptarë.

ECRI i nxit autoritetet shqiptare të ndjekin dhe të intensifikojnë përpjekjet e tyre për ta luftuar trafikimin e fëmijëve.



# **GJETJET DHE REKOMANDIMET**

## **I. Ekzistenca dhe zbatimi i dispozitave ligjore**

### **Instrumentet ndërkombejtare ligjore**

1. Më 26 nëntor 2004, Shqipëria ka ratifikuar Protokollin nr. 12 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila siguron ndalimin e përgjithshëm të diskriminimit, si dhe Protokollit Shtesë të Konventës për Krimin Kibernetikë, lidhur me kriminalizimin e akteve të natyrës raciste ose ksenofobe të kryera nëpërmjet sistemeve kompjuterike. Këto instrumente, kanë hyrë në fuqi më 1 prill 2005, respektivisht më 1 mars 2006.
2. Në raportin e tij të tretë për Shqipërinë, ECRI rekomandoi që vendi të sjellë një përfundim të shpejtë dhe të suksesshëm të procesit të ratifikimit të Konventës Evropiane mbi Pjesëmarrjen e të Huajve në Jetën Publike në Nivel Lokal. Shqipëria ka ratifikuar këtë Konventë më 19 korrik 2005 dhe ajo hyri në fuqi më 1 Nëntor 2005.
3. Në raportin e tij të tretë, ECRI rekomandoi që Shqipëria të nënshkruajë Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale apo Minoritare dhe Konventën Ndërkombejtare mbi Mbrojtjen e të Drejtave të gjithë Punëtorëve Emigrantë dhe Anëtarëve të familjeve të tyre. Pas miratimit të ligjit nr. 9703 prej 2 prill 2007, Shqipëria ka aderuar në Konventën Ndërkombejtare për Mbrojtjen e të Drejtave të gjithë Punëtorëve Emigrantë dhe Anëtarëve të familjeve të tyre më 5 qershor 2007. Shqipëria nuk ka nënshkruar akoma Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Minoriteteve.
4. Në raportin e tij të tretë, ECRI rekomandoi që Shqipëria të bëjë një deklaratë në bazë të nenit 14 të Konventës Ndërkombejtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, në mënyrë që të njohin kompetencën e Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit Racor (KEDR), për të marrë dhe shqyrtuar ankesat individuale për shkelje të kësaj Konverte. Shqipëria nuk e ka bërë ende këtë deklaratë.
5. ECRI rekomandon që Shqipëria të nënshkruajë dhe ratifikojë Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale dhe të Minoriteteve dhe të bëjë një deklaratë në bazë të nenit 14 të Konventës Ndërkombejtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial.

### **Dispozitat kushtetuese dhe dispozitat tjera themelore**

6. Kushtetuta shqiptare garanton parimin e përgjithshëm të barazisë para ligjit dhe mbrojtjen kundër diskriminimit mbi baza të tilla si: raca, origjina etnike, gjuha, feja, statusi social ose prejardhja (neni 18). Kushtetuta gjithashtu ndalon organizatat që mbështesin dhe nxisin urrejtjen raciale, fetare, rajonale ose etnike (neni 9). Më tej, siguron një strukturë të gjerë për mbrojtjen dhe promovimin e identitetit të personave që u takojnë pakicave kombëtare dhe atyre u jep të drejtat dhe liritë (neni 20). Përveç kësaj, të huajt dhe personat pa shtetësi në territorin shqiptar, janë të mbuluar nga të njëjtat të drejta, liri dhe detyrat sikur qytetarët shqiptarë, me përashtim të rasteve kur dispozitat e veçanta në mënyrë specifike kufizojë zbatimin e të drejtave ose të lirive të caktuara këtyre të fundit (neni 16). Në bazë të nenit 122 të Kushtetutës, instrumentet ndërkombejtare të ratifikuara nga Shqipëria, të tilla si Protokolli 12 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, kanë përparësi mbi ligjet kombëtare dhe janë drejtpërdrejtë të zbatueshme në të drejtën e brendshme përveç rasteve nëse zbatimi i tyre kërkon miratim paraprak.

7. Në reportin e tij të tretë, ECRI rekomandon që autoritetet shqiptare të miratojnë legjislacionin e nevojshëm dytësor, në mënyrë që të sigurohet garancia kushtetuese në lidhje me racizmin, barazinë dhe jo-diskriminimin që të mund të zbatohet në praktikë. Gjithashtu, rekomandon që të ndërmerren hapa për të njoftuar opinionin e gjërë si dhe profesionistët ligjorë, për mundësitë e drejtpërdrejta të zbatimit të këtyre garancive kushtetuese.
8. ECRI vë në dukje se, sipas nenit 134 § 1d të Kushtetutës, çdo gjykatë që konsideron se një ligj është jo kushtetues mund t'a referojë si çështje paraprake në Gjykatën Kushtetuese. Sipas nenit 134 § 1g, ankesat individuale në lidhje me shkeljet e pretenduara të Kushtetutës mund të paraqiten në Gjykatën Kushtetuese. Përkundër këtyre dispozitave, ende nuk ka shembull të një vendimi të Gjykatës Kushtetuese mbi zbatimin e parimeve themelore dhe nuk ka pothuajse asnjë legjislacion dytësor i cili lejon zbatimin e tyre efektiv nga ana e gjykatave të zakonshme<sup>1</sup>.
9. ECRI përsërit rekomandimin e tij që autoritetet shqiptare të ratifikojnë miratimin e akteve nënligjore të nevojshme për të siguruar se garancitë kushtetuese lidhur me racizmin, barazinë dhe jo-diskriminimin mund të zbatohen në mënyrë efektive nga ana e gjykatave të zakonshme, në mënyrë që në jetën e përditshme në praktikë, viktimat individuale të diskriminimit të mund të kenë mundësi për një zgjidhje efektive. Ai gjithashtu rekomandon, që të merren iniciativa për të rritur ndërgjegjësimin e profesionistëve ligjore dhe të publikut, për mundësitë për tu mbështetur mbi këto garanci kushtetuese në procedurat para gjykatave të zakonshme.

### **Dispozitat e ligjit zgjedhor**

10. Që nga raporti i tretë i ECRI, autoritetet shqiptare kanë ndërmarrë një reformë të madhe elektorale me miratimin e disa amendamenteve kushtetuese dhe të Kodit Zgjedhor të ri. Një nga objektivat kryesore të reformave ishte për të siguruar hartimin e listave të besueshme të votuesve nëpërmes futjes së modernizuar të regjistrat te kompjuterizuar civil<sup>2</sup>. Lëshimi i kartelave të identifikimit është një masë e rëndësishme që shoqëroi futjen e këtyre regjistrave, pasi që të gjithë votuesit të cilët dëshirojnë të ushtrojnë të drejtën e tyre për votim tash e tutje do t'u kërkohet që të paraqesin kartën e identifikimit ose pasaportën e vlefshme.
11. Shumë aktorë të shoqërisë civile shprehën shqetësimet para zgjedhjeve të përgjithshme të 28 qershori 2009, se këto dispozita të reja, në vend që t'i shërbejnë ndreqjes së mangësive të rëndësishme në saktësinë e listave të zgjedhësve, mund të jenë tepër të kufizuara. Edhe pse shuma e përfshirë ishte e vogël, u kritikua fakti se ka pasur një pengesë në lëshimin e kartave të identitetit, në veçanti përsa i përket natyrës së detyrueshme, pa përashtime të mundshme. Kishte frikë të madhe se familjet me të ardhura të ulëta, mund të gjenden veten në gjendje të pamundur që të regjistrojnë të gjithë anëtarët e familjes së tyre, e cila më pas do t'i privonte të drejtën për të votuar disa individëve. Përsa i përket gjendjes sociale dhe ekonomike të romëve dhe egjiptianëve<sup>3</sup> shqiptarë, është argumentuar se ky problem mund të shkaktonte ndikim te pjesëtarët e këtyre komuniteteve, në mënyrë jo proporcionale. Për më tepër, në rastin e personave që nuk janë të përfshirë tashmë në regjistrat civile, kryesisht romët<sup>4</sup>, vështirësi të tjera të mundshme në lëshimin e kartave të

<sup>1</sup> Shih më poshtë, Dispozitat e së drejtës administrative dhe civile

<sup>2</sup> Veçanërisht shih Opinionin e Përbashkët mbi Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, miratuar nga Komisioni i Venecias në sesionin e tij plenar (Venecia, 13-14 Mars 2009), dokumenti CDL-AD(2009)005

<sup>3</sup> Shih poshtë, Të rrezikuarit /Grupet e synuara – Egjiptianët shqiptarë

<sup>4</sup> Shih poshtë, Të rrezikuarit /Grupet e synuara – Romët: Regjistrimi Civil

identitetit janë përmendur. Mungesa e një regjistri të plotë të adresave në Shqipëri është përmendur si një gjë që ndërlikon më shumë detyrën e dërgimit të njoftimeve individuale te disa prej 700.000 qytetarëve, të cilët nuk janë regjistruar ende; ky shqetësim është kryesisht për anëtarët e varfër të popullsisë, në veçanti, përfshirë këtu edhe komunitetin romë. Autoritetet kanë referuar se do të ndërmarrin masa financiare për të mbuluar koston e regjistrimit të qytetarëve të pafavorizuar me të ardhura të kufizuara, duke përfshirë edhe romët dhe egjiptianët shqiptarë; ECRI e përshtëndet këtë hap si një kontribut të rëndësishëm për të siguruar se e drejta për të votuar është e vërtetë dhe efektive për të gjithë qytetarët. Në të njëjtën kohë, duket se një numër i caktuar i qytetarëve të cilët nuk posedojnë pasaportë të vlefshme, nuk kërkuant të regjistrohen para zgjedhjeve, ECRI vë në dukje se procesi i regjistrimit civil është ende në vazhdim e sipër<sup>5</sup>. Për aq kohë sa kjo mund të ndikojë në të drejtën e tyre për votimin e ardhshëm, ECRI shpreson, se të gjithë qytetarët që nuk posedojnë një pasaportë të vlefshme ose kartë identiteti do të jenë në gjendje për të perfunduar procesin e regjistrimit civil sa më shpejt që të jetë e mundur.

12. ECRI vëren se riorganizimi i zonave elektorale në zona zgjedhore shumë-emërore dhe me të gjithë përfaqësuesit e zgjedhur nën një sistem të përfaqësimit proporcional, nuk ka çuar në krijimin e një sistemi në të cilat minoritetet kombëtare ose gjuhësore të kenë të drejtë për një vend të rezervuar në Kuvendin e Shqipërisë. Përderisa, asnë standard ndërkombëtar nuk kërkon një sistem të tillë që të vihet në vend, kjo kërkesë, për disa përfaqësues të minoriteteve kombëtare ose etno-gjuhësore mbetet në rendin e ditës. Sipas ligjit shqiptar është i ndaluar formimi i partive politike që përfaqësojnë interesat e pakicave të veçanta. Edhe pse kjo pasqyron një dëshirë të ligjshme për të shmhangu ndarjet politike përgjatë vijave etnike, ajo megjithatë është perceptuar nga disa minoritete si një pengesë shtesë për promovimin e të drejtave të minoriteteve, veçanërisht në një kontekst, ku Komiteti Shtetëror për Minoritetet nuk luanë ndonjë rol të rëndësishëm dhe ku disa grupe do të dëshironin të shohin këtë rol<sup>6</sup>.
13. ECRI fuqimisht rekomandon që autoritetet shqiptare të ndërmarrin të gjitha masat për tci mundësuar votimin të gjithë personave në moshë votimi, atyre të cilëve nuk i është marrë e drejta qytetare për votim; por inkurajon autoritetet shqiptare për të vazduar përpjekjet e tyre me qëllim të veçantë që të sigurojnë se, për arsy e kryekëput financiare askush nuk përjashtohet nga votimi.
14. ECRI i inkurajon autoritetet shqiptare të qëndrojnë të vëmendshme për thirrjet e përfaqësuesve të grupeve të caktuara minoritare për të lëna mënjanë vende për përfaqësuesit e pakicave në Kuvendin e Shqipërisë dhe për të kërkuar zgjidhje, ose brenda legjislaturës ose mes institucioneve të tjera, të cilat lejojnë që shqetësimet e grupeve minoritare të merren parasysh më mirë.

#### **Dispozita e ligjit penal kundër racizmit**

15. Në raportin e tij të tretë, ECRI rekomandoi që autoritetet shqiptare të parashikonin në ligjin penal se motivi racist do të përbënte rr Ethanë rënduese pa marrë parasysh natyrën specifike të veprës së kryer. Ai rekomandoi marrjen e masave të nevojshme që të garantonin zbatimin efektiv të dispozitave të ligjit penal në lidhje me racizmin, diskriminimin dhe jo tolerancën dhe rikonfirmoi rëndësinë e trajnimit dhe rritjes së vetëdijes në këtë drejtim. ECRI gjithashtu rekomandoi që të mblidhen të dhëna të mëtejshme në lidhje me zbatimin e

<sup>5</sup> Shih poshtë, Të rezikuarit /Grupet e synuara – Romët: Regjistrimi Civil

<sup>6</sup> Shih poshtë, Organet anti-diskriminuese dhe institucionet tjera – Komiteti Shtetëror për Minoritetet

dispozitave të ligjit penal kundër racizmit, në mënyrë që të vlerësohet efektiviteti i tyre.

16. ECRI përshtendet miratimin nga Kuvendi i Shqipërisë, më 26 shkurt 2007, të ligjit nr. 9686 për ndryshimin e Kodit Penal, i cili tashmë parashikon se natyra raciste e një krimi ose urrejtjes së bazuar do të përbëjë një rrethanë rënduese. Ky rregullim i ri mbulon motivet bazë të gjinisë, racës, fesë, kombësisë, gjuhës dhe besimeve politike, fetare ose sociale. Autoritetet shqiptare gjithashtu theksuan se i njëjtligj parashikoi në Kodin Penal një definicion të ri të krimit të torturës, i cili përfshin të gjitha veprat që u shkaktojnë viktimate vuajtje të rënda fizike, mendore, ku vepra të tillë janë të kryera me dashje nga një person që mban zyrë publike, me pëlqimin e tij ose të saj të nënkuptuar ose mbi çfarëdo baze diskriminuese.
17. Autoritetet shqiptare gjithashtu raportuan se, më 27 nëntor 2008, Kuvendi shqiptar miratoi ligjet nr 10.023 për ndryshimin e Kodit Penal dhe nr 10.024 për ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale, të dyja me qëllim që t'i mundësojnë Shqipërisë përmbytjen e plotë të detyrimet të saja që dalin nga ratifikimi i Konventës mbi Kibernetikën dhe Protokollin Shtesë, në lidhje me kriminalizimin e akteve të natyrës raciste ose ksenofobe të kryera nëpërmjet sistemeve kompjuterike. Shpërndarja me anë të mjeteve kompjuterike të deklaratave raciste ose ksenofobe, kërcënimet ose fyerjet tani janë të ndaluar. Procedurat e veçanta për hetimin e akteve të tillë janë gjithashtu të përcaktuara.
18. Që nga raporti i tretë i publikuar i ECRI-it, janë bërë përpjekje për të siguruar që skemat e trajnimeve fillestare dhe vazhduese për oficerët e policisë dhe anëtarët e gjyqësorit të mbulojnë në mënyrë sistematike çështjet e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. ECRI vëren me interesim se një numër i caktuar i sesioneve trajnuese është mbajtur që nga publikimi i raportit të tretë të tij për të ngritur vetëdijen në mesin e gjyqtarëve, prokurorëve publikë dhe oficerëve të policisë, veçanërisht në lidhje me çështjet e ndërlidhura me zbatimin e dispozitave të ligjit penal të racizmit, diskriminimit dhe jo tolerancës dhe rekomandimet e bëra nga ECRI në Rekomandimin e Nr.11 për Politikat e Përgjithshme mbi luftimin e racizmit dhe diskriminimit racial në polici. Megjithatë, asnjë informacion nuk mund të sigurohet për ndikimin e këtyre sesioneve trajnuese dhe duket se deri tani, ato janë ndjekur vetëm nga një numër i vogël i njerëzve që punojnë brenda sistemit të drejtësisë penale.
19. Ekzistojnë shumë pak të dhëna për zbatimin e dispozitave të ligjit penal në lidhje me racizmin, diskriminimin dhe jo tolerancën. Autoritetet shqiptare kanë tërhequr vëmendjen për të dy rastet e sjella para gjykatave, në vitin 2005 dhe 2006, në bazë të nenit 266 të Kodit Penal (prishja e rendit publik, nga nxitja e urrejtjes ndaj segmenteve të popullsisë). Nuk ka ende shifra në dispozicion në lidhje me zbatimin e neneve të reja të shtuara të Kodit Penal pas miratimit të ligjit nr. 9686 i vitit 2007 dhe ligjit nr. 10.023 të vitit 2008.
20. ECRI përsëri u rekomandon autoriteteteve shqiptare që të marrin masat e nevojshme për të garantuar zbatimin e dispozitave të ligjit penal në lidhje me racizmin, diskriminimin dhe jo tolerancën. Ai nënizon rëndësinë e ofrimit për të gjithë personat që punojnë brenda sistemit të drejtësisë penale - anëtarët e forcave të policisë, shërbimit të prokurorisë, të gjyqësorit dhe juristëve - trajnime të veçanta lidhur me dispozitat përkatëse të ligjit kombëtar, dhe për ngritjen e vetëdijes së tyre për dispozitat e reja të miratuara në vitin 2007 dhe 2008. Ai inkurajon autoritetet që të rrisin përpjekjet e tyre për këtë qëllim, në mënyrë që të arrijnë një numër më të madh i njerëzve që punojnë në këtë fushë. Ai gjithashtu përsërit rëndësinë e të bërit të zyrtarëve të ndjeshëm ndaj problemeve të racizmit, diskriminimit dhe jo tolerancës.

21. ECRI rekomandon mbledhjen e të dhënave të mëtejshme në lidhje me zbatimin e dispozitave të ligjit penal në këtë fushë, në mënyrë që të vlerësohet efikasiteti i tyre; këto të dhëna duhet të mbulojnë fazat e ndryshme të procedimit penal, nga dorëzimi i një ankesë te rezultati përfundimtar.

### **Dispozitat e së drejtës administrative dhe civile**

22. Në raportin e dytë për Shqipërinë, ECRI vinte në dukje dispozitat që sigurojnë barazinë e të drejtave në disa fusha të jetës, si edukimi. Gjithashtu, është vënë në dukje se Kodi i Punës (neni 9) garanton mosdiskriminimin, si në sferën publike ashtu edhe në sferën private. Neni 202 i Kodit të Punës siguron që një gjybë duhet të aplikohet për shkeljet të nenit 9, dhe neni 201 siguron që punonjësit të cilët janë viktimi e diskriminimit do të zhđëmtohen. Në raportin e dytë dhe të tretë, ECRI megjithatë, rekomandonte që autoritetet shqiptare të vendosnin një legjislacion të plotë kundër diskriminimit, që synon të luftojë kundër diskriminimit të drejtëpërdrejtë dhe të tërthortë në fushat kryesore të jetës. Në lidhje me këtë, ai vuri në dukje rolin edukativ dhe parandalues që një legjislacion i tillë mund të luajë, dhe dobinë e tij në zbulimin e praktikave diskriminuese.
23. Ende nuk ka ndonjë ligj të përgjithshëm kundër diskriminimit. Aktualisht, ende nuk janë përfshirë një numër fushash sociale, si: strehimi, kujdesi shëndetësor dhe mundësia ndaj shërbimeve publike nga legjislacioni i cili ndalon diskriminimin. ECRI kupton se aktorët e shoqërisë civile, me ndihmën e specialistëve ligjorë shqiptarë dhe të huaj, kanë hartuar një projektligj kundër diskriminimit. Megjithatë, deri tanë, ky projektligj nuk është paraqitur për shqyrtim në komisionet përkatëse të Kuvendit.
24. ECRI përsëri u tërheq vëmendjen autoriteteve shqiptare për Rekomandimin e tij nr. 7 për Politikën e Përgjithshme për legjislacionin kombëtar në luftën kundër racizmit dhe diskriminimit racial, i cili përmban rekomandime të hollësishme për dispozitat, të cilat ECRI mendon se duhet të përfshihen në një ligj të vetëm civil dhe administrativ kundër diskriminimit racial. Në këtë rekomandim, ECRI vuri në dukje se një legjislacion i tillë duhet të zbatohet jo vetëm për diskriminim direkt, por edhe për diskriminimin të tërthortë. Rekomandimi gjithashtu përcakton një varg masash që mund të lehtësojnë zbatimin e legjislacionit në këtë fushë, duke përfshirë zhvendosjen e barrës së provës. ECRI u tërheq vëmendjen autoriteteve shqiptare për rëndësinë jetike të masave të përshtatshme ligjore, për të luftuar racizmin dhe diskriminimin racial në mënyrë efektive dhe në një mënyrë e cila vepron si një pengesë; ai thekson se ligji kundër racizmit dhe diskriminimit racial gjithashtu luan një rol edukues brenda shoqërisë, transmeton mesazh të fuqishëm se nuk do të tolerohet asnjë tentativë për të legjitimuar racizmin dhe diskriminimin racial në një shoqëri të sunduar nga ligji.
25. ECRI u rekomandon përsëri autoriteteve shqiptare të forcojnë edhe më shumë kuadrin ligjor në fushën e së drejtës civile dhe administrative, me qëllim e futjes së një legjislacioni të plotë për luftën kundër diskriminimit të drejtëpërdrejtë dhe të tërthortë në fushat kryesore të jetës. Për këtë qëllim, ai i referohet Rekomandimit nr. 7 pr Politikën e Përgjithshme mbi legjislacionin kombëtar për luftën kundër racizmit dhe diskriminimit racial.

### **Administrimi i drejtësisë**

26. Në raportin e tij të tretë, ECRI u rekomandoi autoriteteteve shqiptare të vazhdojnë e të forcojnë përpjekjet e tyre për të përmirësuar funksionimin e sistemit gjyqësor. Autoritetet kanë vazhduar përpjekjet e tyre në këtë drejtim, në veçanti në zhvillimin e infrastrukturës, përmirësimin e administrimit të procedurave dhe trajnimin e stafeve të sistemit gjyqësor për zbatimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Megjithatë, duhet të theksohet, se funksionimi i sistemit

gjyqësor<sup>7</sup> vazhdon të ketë probleme, ashtu edhe siç është pranuar nga autoritetet shqiptare të cilët janë duke punuar në këtë fushë.

27. Deri kohët e fundit, në Shqipëri, ndihma ligjore ishte në dispozicion vetëm në lidhje me rastet penale. Më 22 dhjetor të vitit 2008, Kuvendi miratoi ligjin nr.10039 "Për ndihmën Juridike", e cili hyri në fuqi në fillim të vitit 2009 dhe vendosi një sistem për ofrimin e ndihmës ligjore për ata që kanë nevojë, duke përfshirë rastet civile. ECRI e mirëpret këtë veprim. Ai nënvizon vështirësitë e veçanta që mund të jenë hasur nga viktimat e diskriminimit racial në sigurimin e mundësisë për në gjykata, për shembull, për problemet financiare ose për vështirësitë, ose raste të tilla si: njoħuri të pamjaftueshme për ligjin përkatës ose vështirësi në mbledhjen e dëshmive të nevojshme. Këto vështirësi mund të pérkeqësohen, aty ku mungon legislacioni i plotë kundër diskriminimit. ECRI shpreson se, ashtu edhe siç është caktuar në Rekomandimin Nr. 7 për Politikat e Përgjithshme mbi legislacionin kombëtar për të luftuar racizmin dhe diskriminimin racial, miratimi i këtij ligji do të garantojë praktikë në ndihmë juridike falas dhe aty ku është e nevojshme, një avokat i caktuar nga gjykata për viktimat të cilët dëshirojnë të dalin para gjykatave si ankues ose paditës dhe të cilët nuk kanë mjete të nevojshme për ta bërë këtë. Në këtë kontekst, theksohet nevoja për të siguruar që të gjithë aktorët që kanë lidhje me këtë çështje, brenda sistemit ligjor janë plotësisht të njoħur me dispozitat e reja që rregullojnë ndihmën juridike, dhe se publiku i gjerë është bërë i vetëdijshëm për të zgjeruar mundësitë e zbatimit të të drejtave të tyre.
28. Duke pasur parasysh, posaçërisht rolin e rëndësishëm të gjykatave në sigurimin e mjeteve juridike efektive që janë në dispozicion për viktimat e krimeve raciste ose diskriminim racor, ECRI i nxit autoritetet shqiptare që të vazhdojnë përpjekjet e tyre për të përmirësuar funksionimin e sistemit gjyqësor.
29. ECRI i fton autoritetet që të kenë parasysh që viktimat e diskriminimit racial të kenë mundësi efektive në ndihmën juridike falas, kudo që ata i përmbushin kërkesat sipas sistemit të ri të ndihmës juridike, dhe rekomandon që ata të marrin të gjitha masat e nevojshme për ngritjen e vetëdijes mes publikut të gjerë dhe profesionistëve ligjore për sistemin e ri të ndihmës ligjore që është miratuar.

### **Organet anti-diskriminuese dhe institucionet tjera**

- *Ombudsmani (Avokati i Popullit)*
30. Sipas Kushtetutës së Shqipërisë, Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individëve kundër veprimeve të paligjshme ose të parregullta ose mosveprimet e organeve të administratës<sup>8</sup> publike. Në raportin e tij të tretë për Shqipërinë, ECRI bëri një numër rekomandimesh duke synuar që Zyra e Avokatit të Popullit, sistematikisht, të marrë parasysh çdo aspekt të mundshëm diskriminuese të ankesave të pranuara dhe duke u munduar të zbulojë sjellje diskriminuese, qoftë ato të të drejtpërdrejta ose të tërthorta. Ai gjithashtu inkurajoi Zyrën që t'i kushtojë vëmendje të veçantë të drejtave të fëmijëve romë ose egjiptianë. Në të njëjtën kohë, ECRI ka inkurajuar autoritetet shqiptare të marrin në konsideratë krijimin e një organi të pavarur të specializuar për të luftuar racizmin dhe diskriminimin racial.

<sup>7</sup> Shih, p.sh raportin vjetor 2007 të Avokatit të Popullit, i cili përmend numrin dhe llojet e ankesave të pranuara në lidhje me sistemin juridik (kërkesat u deklaruan si të papranueshme pasi Avokati i Popullit nuk ka kompetenca në këto çështje).

<sup>8</sup> Neni 60(1) i Kushtetutës.

31. Që nga raporti i tretë i ECRI, Avokati i Popullit ka vazhduar konsolidimin e rolit që ai luan në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në të gjitha fushat brenda kompetencave të tij; aty ku është e nevojshme, Zyra e Avokatit të Popullit jep këshilla për ankesa mbi mënyrat e tjera ku kërkohet dëmshpërbllimi. Seksioni përgjegjës për trajtimin e çështjeve lidhur me të drejtat e fëmijëve ka vazhduar aktivitetet e tij për të promovuar të drejtat e gjithë fëmijëve. Që nga viti 2008, burimet e Zyrës janë përforcuar për të mundësuar që ajo të luajë rolin e saj të ri të mekanizmit kombëtar për parandalimin e torturës në përputhje me Nenin 17 të Protokollit Fakultativ të Konventës kundër Torturës dhe Trajimit Mizor, Çnjerëzor ose Poshtërues ose Dënimit<sup>9</sup>.
32. ECRI mirëpret këto elemente pozitivë dhe përshëndet angazhimin e Avokatit të Popullit dhe Zyrës së tij për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Shqipëri. Falë këtij angazhimi, institucioni tani gjëzon kredibilitet të konsiderueshëm brenda vendit. ECRI megjithatë shpreh keqardhje, se qasja e Zyrës, para së gjithash e bazuar në barazi formale para ligjit, nuk e bën më të lehtë identifikimin e rasteve të diskriminimit racor; çështje të tilla duken se mbeten gjerësisht të munguara në punën e kësaj zyre. ECRI rithekson se aspektet diskriminuese të një ankesë, jo gjithmonë janë menjëherë të qarta – edhe për viktimën – dhe kjo për arsy se ato paraqiten krejt të padëmshme, është vështirë të identifikohen dhe provohen rastet e diskriminimit jo të drejpërdrejtë. Për këtë arsy, ECRI përsëri thekson përfitimet që sjellë nëse Ombudsmani mbledhë të dhëna lidhur me prejardhjen etnike dhe kombëtare të ankuesve, gjersa i respekton tërësisht parimet e konfidencialitetit dhe vetëidentifikimit të personave në fjalë. ECRI thekson në mënyrë të veçantë që autoritetet kanë treguar se forma e re do tu ofrohet ankuesve, formë kjo që përfshin edhe çështjet lidhur me diskriminimin e mundshëm të bazuar në prejardhjen kombëtare, etnike ose raciale, sikur edhe faktin se rishtas është emëruar një ekspert ligjor që do të merret me sjelljet raciste ose diskriminuese. Përderisa është ende herët të vlerësohet ndikimi i këtyre zhvillimeve në praktikë, ECRI shpreson se këto zhvillime do të lejojnë një qasje sistematike në rastet e diskriminimit racial. ECRI vëren se roli potencial i Ombudsmanit që të vërë në pah rastet e diskriminimit përmes ankesave me të cilat merret, do të jetë më i rëndësishëm, sidomos kur dihet se aktualisht në Shqipëri askush nuk ka përgjegjësi specifike përluftimin e diskriminimit racor.
33. ECRI i rekomandon Zyrës së Avokatit të Popullit t'i kushtojë vëmendje të veçantë aspekteve të ankesave të mundshme diskriminuese, edhe nëse ato nuk janë ngritur nga ankuesi, dhe në lidhje me këtë, thekson se do të ishte më e përshtatshëm për të siguruar trajnime statit të Zyrës, për mënyrat e ndryshme në të cilat racizmi dhe diskriminimi mund të manifestojnë vetveten.
34. ECRI fuqimisht e inkurajon Zyrën e Avokatit të Popullit në përpjekjet e saja të reja, që të regjistrojë origjinën etnike ose kombëtare të ankuesit, si pjesë e praktikave normale të tij operative, në mënyrë që të ndriçohen rastet e diskriminimit, qofshin ato të drejtëpërdrejta ose të tërthorta, dhe thekson nevojën për të respektuar parimet e konfidencialitetit dhe vetëidentifikimit vullnetarë nga personat përgjegjës. Ai inkurajon Zyrën e Avokatit të Popullit, të shqyrtojë rregullisht praktikën e tij në këtë fushë, në mënyrë që të sigurojë që mekanizmat e vendosur të janë efektive dhe në përputhje të plotë me parimet e mësipërme.

<sup>9</sup> Shih raportin vjetor 2007 të Avokatit të Popullit, faqja. 44-45, përkthim në gjuhën angleze. Shih gjithashtu, Protokollin Fakultativ të Konventës [të Kombeve të Bashkuara] kundër Torturës dhe Trajimit tjetër Mizor, Çnjerëzor ose Poshtërues ose Dënimit : Pjesa IV, Mekanizmat parandalues kombëtar, Neni 17: " Çdo Shtet Palë do të mbajë, të caktojë ose krijojë, së paku një vit pas hyrjes në fuqi të Protokollit të pranishëm ose të ratifikimit ose të aderimit, një ose disa mekanizma të pavarur kombëtarë parandalues për parandalimin e torturës në nivel kombëtar ..."

35. ECRI fuqimisht rekomandon që autoritetet shqiptare të sigurojnë ekzistencën e një organi të specializuar në luftën kundër racizmit dhe diskriminimit racial, duke u frymëzuar nga Rekomandimi Nr. 2 i Politikave të Përgjithshme, mbi organet e specializuara për të luftuar racizmin, ksenofobinë, antisemitizmin dhe jo tolerancën në nivel kombëtar dhe Nr. 7, mbi legjislacionin kombëtar për të luftuar racizmin dhe diskriminimin racial.
- *Komiteti Shtetëror për Minoritetet*
36. Në Mars të vitit 2004, Këshilli i Ministrave krijoi Komitetin Shtetëror për Minoritetet, që i përgjigjet Kryeministrat, dhe që ka për detyrë të jepë rekomandime në qeveri lidhur me masat që duhen ndërmarrë për të përmirësuar gjendjen e personave të cilët u përkasin grupeve minoritare<sup>10</sup>. Në raportin e tij të tretë, ECRI rekomandoi që, ky Komision i sapoformuar t'i kushtojë kujdes çështjeve të diskriminimit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë. Gjithashtu, ai rekomandoi që autoritet shqiptare të sigurojnë që Komiteti të ketë burime njerëzore dhe burime të nevojshme financiare për të funksionuar në mënyrë efektive.
37. Që nga raporti i tretë i ECRI-it, Komiteti Shtetëror për Minoritetet ka konsoliduar përvojën e tij dhe janë dhënë burime shtesë. Për shembull, është rritur numri i personave të cilët punojnë në Komitet. Autoritetet shqiptare, gjithashtu, kanë vënë në dukje se tani shpejt kanë miratuar hapjen e zyrave rajonale në disa qytete të Shqipërisë, përveç Tiranës, duke nënkuptuar se nevojiten ende burime shtesë. Megjithatë, disa përfaqësues të minoriteteve vazhdojnë të shprehin skepticizmin, madje edhe shumë kritika, në lidhje me efektivitetin e mekanizmit. Në këtë kontekst, ECRI vë në dukje se anëtarët e Komitetit janë të emëruar pa u konsultuar në mënyrë të përshtatshme me përfaqësuesit e minoriteteve përgjegjëse; kjo dëmontr besueshmërinë e Komitetit, si një organ që duhet të mbrojë interesat e çdo minoritetit të njojur. Në këtë aspekt, ECRI vë në dukje se në qoftë se ky organ është i perceptuar nga minoritetet si i paaftë për të përfaqësuar interesat e tyre, atëherë ai nuk do të jetë në gjendje ta kryejë plotësisht detyrën e tij, dhe varet nga besimi i vendosur prej këtyre grupeve të cilat synon t'i përfaqësojë. Megjithatë, vetëm tre "minoritetet kombëtare" (greke, maqedonase dhe serbo-malazeze<sup>11</sup>) dhe dy "pakicat etnogjuhësore (rome dhe vllah/arumunë) janë të përfaqësuara në Komitet<sup>12</sup>; edhe pse vetë komiteti nuk është kundër një zgjerimi të anëtarësisë ose për të luftuar diskriminimin me të cilën ballafaqohen grupe të tjera, problemet që kanë të bëjnë me mungesën e njoħjes ligjore të bashkësive egiptiane dhe boshnjake si minoritete<sup>13</sup> nënkuptojnë se deri tani, asnjë anëtarë që përfaqëson këto komunitete nuk është i përfshirë.
38. Në lidhje me kompetencën e tij, mund të vërehet se Komiteti ka vetëm rol këshillues pa autoritet vendimmarrës. Një numër i caktuar i përfaqësuesve të minoriteteve, do të donin që ky komitet të transformohet në Ministri në mënyrë që të ketë ndikim më të madh mbi vendimet. Komiteti Këshillues mbi Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare ka theksuar pengesat e pandara, në një situatë ku pritet që organi qeveritar t'i përfaqësojë në mënyrë të drejtpërdrejtë interesat e minoriteteve dhe nënvizoi rëndësinë e krijimit të një

<sup>10</sup> Vendimi i Keshillit të Ministrave Nr. 127 i 11 marsit 2004 krijimi i Këshillit Shtetëror të Minoriteteve.

<sup>11</sup> Terminologjia e përdorur nga ECRI, për të paraqitur minoritetet në këtë raport është po ajo terminologji e cila është përdorur gjatë bisedave me autoritetet dhe me përfaqësuesit e këtyre minoriteteve aty për aty, të cilët referoheshin vazhdimisht minoriteteve "serbo-malazeze".

<sup>12</sup> Në lidhje me dallimet midis minoriteteve kombëtare dhe etno-gjuhësore, shih më poshtë / të rezikuarit Grupet e synuara - greqisht, maqedonisht, serbo-malazeze dhe minoritetet vllehe-arumune, komunitetit boshnjak.

<sup>13</sup> Shih poshtë, / Të rezikuarit/ Grupet e synuara.

kuadri institucional të favorshëm për dialog, midis autoritetetve nga njëra anë dhe të minoritetave, në anën tjetër<sup>14</sup>. ECRI vë në dukje se, sipas informacioneve të siguruara nga autoritetet, Komiteti, rishtazi mori iniciativën për të propozuar ndryshime në statusin e tij të cilat synojnë të plotësojnë funksionet e veta konsultative me kompetenca vendimmarrëse; ECRI shpreson se kjo iniciativë do të kontribuojë në përmirësimin e dialogut institucional ndërmjet autoritetetve dhe minoritetave.

- 39. Nën dritën e rekomandimeve të Komitetit Këshillues mbi Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, ECRI rekomandon që autoritetet shqiptare të rishqyrtojnë marrëveshjet institucionale, për të mundësuar pjesëmarrje të personave që u përkasin minoritetave në proceset e vendimmarries dhe mënyrën në të cilën anëtarët e organit në fjalë janë emëruar. Në lidhje me këtë, ECRI sugjeron që autoritetet, në konsultim me minoritetet përkatëse, të kërkojnë mënyra për të garantuar më mirë përfaqësimin e anëtarëve të Komitetit Shtetëror për Minoritetet, dhe se kompetencat e këtyre të fundit të rishikohen sipas nevojës, në mënyrë që të mundësohet kryerja efektive e detyrës.
- 40. ECRI rekomandon që autoritetet shqiptare të sigurojnë që Komiteti Shtetëror për Minoritetet të ketë burime njerëzore dhe burime të mjaftueshme financiare, për të funksionuar në mënyrë sa më efektive, veçanërisht përsa i përket operimit të zyrave të reja rajonale jashtë Tiranës.
- 41. Ai përsëri i rekomandon Këshillit Shtetëror për Minoritetet që t'i kushtojnë vëmendje çështjeve të diskriminimit, duke përshirë edhe diskriminimin e tërthortë.

## **II. Diskriminimi në fusha të ndryshme**

### **Strehimi**

- 42. Në raportin e tij të tretë për Shqipërinë, ECRI ka inkurajuar autoritetet në përpjekjet e tyre për rregullimin e situatave të paligjshme për strehim dhe për të ndihmuar personat e pastrehë, dhe rekomandoi që ata të sigurojnë që komunitetet rome dhe egjiptiane të janë të përfshira në iniciativa të tillë ashtu siç duhet. Gjithashtu, ai rekomandoi që ata të sigurojnë se romët ose egjiptianët që janë dëbuar nga shtëpitë e tyre, të kenë të njëjtën mundësi të strehimit alternativ dhe të kreive të strehimit sikurse qytetarët e tjera shqiptarë dhe gjithashtu, të sigurojnë që të hetohen të gjitha raportimet e diskriminimit lidhur me largimet me dhunë.
- 43. Ashtu sikurse autoritetet shqiptare kanë vunë në dukje në Strategjinë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Komunitetit Rom, shumë familje rome që ishin viktima të rënies së skemave piramidale të kursimit në fund të viteve 1990, kanë humbur shtëpitë e tyre dhe më pas u detyruan të improvizojnë banesa pa garanci si dhe me kushte minimale higjienike. Prej vitit 2003, sipas kësaj strategjie, masa të ndryshme ishin parashikuar për të përmirësuar kushtet e strehimit për romët. Disa fusha mbulohen duke përfshirë identifikimin dhe zbatimin e masave konkrete për të siguruar që çdo familje ka strehim të mirë, lidhja e vendbanimeve të romëve me rrjetin e energjisë elektrike, ujin e pijshëm dhe kanalizimet, dhe për komunitetet më të izoluara, një studim për kërkeshat e ndërtimit të rrugës. Në vitin 2005 Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit kreua një vlerësim të nevojave në këto zona; autoritetet kanë treguar se shuma e përgjithshme financiare e parashikuar dhe që kërkohet për të sjellë kushtet e banimit të romëve deri në

<sup>14</sup> Komiteti Këshillues mbi Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Minoritetave Kombëtare, opinioni i dytë në Shqipëri, ACFC/OP/II(2008)003, miratuar më 29 Maj 2008, vërejtjet lidhur me nenin 15.

një nivel standard është 866 milion lek. Sipas autoriteteteve, zbatimi i këtyre projekteve është duke hasur vështirësi në realizim, duke marrë parasysh shumëllojshmérinë e furnizuesve publikë dhe privatë dhe vetë faktin se një numër i madh i pjesëmarrësve të ndryshëm janë përfshirë aktualisht në kryerjen ë punës. Në tetor të vitit 2007, qeveria ratifikoi një marrëveshje kredie të propozuar nga Këshilli i Bankës Evropiane për Zhvillim, në një total prej 15 milion euro, që do të përdoret në një numër të komunave me një proporcion të madh të banorëve romë, për ndërtimin e banesave sociale për 1.100 familje të pastreha. Megjithatë, nën kushtet e zbatimit të kësaj kredie, përfituesit e programit të ardhshëm për t'u përfshirë në skemë kanë nevojë për ndihmë juridike. Gjithashtu, autoritetet kanë treguar se, për herë të parë, në vitin 2008, qeveria ka ndarë një buxhet prej 30 milion lekë (ekuivalent me rreth 230.000 euro) për të financuar projekte për ndërtimin ose rehabilitimin e shtëpive sipas Strategjisë. Megjithatë, në këtë kontekst, shumë pak komuna kanë marrë iniciativën e paraqitjes së projekteve dhe ato të cilat kanë nisur projekte, në fakt kanë hasur ndonjëherë në probleme. Si rezultat, vetëm një e treta e buxhetit të ndarë është shndërruar në rezultate të prekshme.

44. ECRI përshtendet masat e marra tashmë, të cilat janë një hap i nevojshëm drejt përmirësimit të kushteve të strehimit për romët. Megjithatë, duhet të theksohet se kushtet e jetesës për shumë familje rome mbèsin të tmerrshme, sepse ata jetojnë në shtepi të shkatërruara, pa mundësi të pasjes së ujit të pijshëm ose të rrjetit të energjisë elektrike, kanalizimit dhe zakonisht janë të vendosur në pjesët e jashtme të qyteteve ose në zona të izoluara. Mungesa e investimeve, madje edhe ndonjë interes në këto probleme nga ana e shumë autoriteteteve vendore, megjithëse ata janë përgjegjëse për zbatimin e projekteve konkrete, dhe dështimi i tyre për të marrë parasysh nevojat specifike të familjeve përgjegjëse, pengon përparimet e mëtejshme në këto çështje. Disa prej objektivave afatmesme të përgjithshme të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe të Shansave të Barabarta, të tilla si: pasje e ujit të pijshëm, përmirësimi i infrastrukturës së kanalizimeve dhe ndërtimi i banesave sociale, kanë një rëndësi të veçantë për komunitetet<sup>15</sup> rome. Edhe pse politikat kombëtare kanë qenë të zhvilluara në këto fusha, ECRI tërheq vëmendjen për nevojën për të përforçuar zbatimin e tyre në nivel vendor. Në lidhje me këtë, disa aktorë në këtë fushë kanë argumentuar se do të ishte e dëshirueshme për të shoqëruar këto politika kombëtare me masa të detyrueshme në nivel vendor në mënyrë që të detyrojnë bashkitë për të vepruar.
45. Përveç kushteve të këqija të banimit dhe infrastrukturës jo të përshtashme të përmendura më lart, përfaqësuesit e komuniteteve rome dhe egjyptianë kanë raportuar se pjesëtarët e komuniteteve të tyre kanë qenë të diskriminuar përsëri duke u dëbuar nga shtëpitë e tyre. Ashtu, siç edhe ECRI vuri në dukje në raportin e tij të tretë, që nga ndryshimi i regjimit në Shqipëri në fillim të viteve 1990, shumë njerëz kanë zaptuar tokën pa titull ligjor dhe kanë ndërtuar (illegalisht) shtëpitë në këto vende. Ndërsa masat e marra nga autoritetet për të zgjidhur këtë çështje, ECRI gjithashtu përmendi miratimin e ligjit nr. 9304 për Legalizimet dhe Urbanizimit e Zonave jo formale, autoritetet i referohen edhe ligjit nr. 9482 të 3 prill 2006 për Legalizimet, Urbanizimit dhe integrimin e Ndërtimeve të paligjshme. Megjithatë, ECRI vëren me shqetësim, se një numër i zonave të banuara nga Romët nuk janë të përfshira në zonat jo formale të mbuluara nga ky legjislacion dhe zbatimi i pjesshëm i Strategjisë, dhe si pasoje e kësaj, kjo vazhdon të paraqesë probleme<sup>16</sup>. Përveç kësaj, sipas statistikave zyrtare, vetëm 4.3 për qind e romëve posedojnë tokën e cila është zënë nga

<sup>15</sup> Raporti i Progresit për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Komunitetit Romë, faqe 58.

<sup>16</sup> Raporti i Progresit për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Komunitetit Romë, faqe 55.

shtëpitë e tyre, 87 për qind e vendeve të zëna nga romët i takojnë pronarëve të tjerë privatë dhe 8.7 për qind i takon shtetit<sup>17</sup>. ECRI vëren se, veçanërisht romët janë në rrezik për t'u dëbuar dhe është i shqetësuar që disa familje tashmë janë dëbuar pa u rivendosur diku tjetër dhe, duke gjetur veten pa strehë dhe pa burime të mjaftueshme financiare, në disa raste janë detyruar të ndërtojnë një banesë të re, përsëri pa leje, që ata përsëri e zënë nën kushte shumë të pasigurta.

46. ECRI tërheq vëmendjen autoriteteve shqiptare për faktin se mundësia për strehim të përshtatshëm është një aspekt kyç për përmirësimin e kushteve të jetesës për Romët, jo vetëm si një e drejtë themelore, por edhe sepse ai është i lidhur ngushtë me të drejtat e tjera sociale të tilla si drejtët për shëndet. Ai gjithashtu thekson se mundësia për një strehim të përshtatshëm është një nga çështjet kryesore të ngritura nga përfaqësuesit e romëve me ECRI-in.

47. ECRI fuqimisht rekomandon që autoritetet shqiptare të vazhdojnë përpara me zbatimin e masave konkrete, në konsultim me komunitetet në fjalë, për të siguruar që çdo familje rome të ketë mundësinë e një strehimi të përshtatshëm, duke përfshirë lidhjen e marrëveshjes me romët që të kenë mundësi të rrjetit të energjisë elektrike, të ujtit të pijshëm, kanalizimit dhe rrjeteve rrugore. Ai rekomandon që autoritetet të rregullojnë qartazi objektivat dhe grupet që synojnë në këtë drejtim, për të paktën dy vitet e ardhshme dhe të publikojnë raporte të rregullta mbi progresin e bërë.

48. Ai gjithashtu inkurajon autoritetet shqiptare që të shtojnë përpjekjet e tyre për të përfshirë autoritetet vendore në zbatimin e asaj pjesë të Strategjisë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetësës së Komunitetit Rom, sidomos në lidhje me strehimin, një fushë në të cilën qeveria vendore luan një rol jetik. Lidhur me këtë, ECRI i nxit autoritetet kombëtare që të parashikojnë futjen e masave të detyrueshme për autoritetet vendore, ose të paktën për të zgjeruar politikën duke i dhënë përparësi, në dhënen e granteve për projektet që kanë për qëllim dhënen fund të diskriminimit de facto.

49. ECRI rekomandon që autoritetet shqiptare të hetojnë të gjitha raportet e diskriminimit të cilat kanë të bëjnë me dëbimet. Ai përsëri rekomandon që autoritetet të sigurojnë se romët ose egjiptianët, të cilët janë dëbuar nga shtëpitë e tyre, të marrin të njëjtën mundësi të strehimit alternativ dhe të kreive të strehimit si qytetarët e tjerë shqiptarë.

50. ECRI inkurajon autoritetet në përpjekjet e tyre për rregullimin e situatave të paligjshme të strehimit dhe rekomandon që ata të sigurojnë që komunitetet rome dhe egjiptiane të përfshihen në iniciativa të tilla ashtu siç duhet. Në lidhje me këtë, ai rekomandon që autoritetet, në veçanti të kenë përparësi për të kërkuar zgjidhje për personat që jetojnë në zonat të cilët nuk përfshihen nga ligji Nr. 9304 në Legalizimin dhe Urbanizimin e Zonave jo formale.

Arsimi

- *Pjesëmarrja e fëmijëve romë dhe egjiptianë*

51. Në raportin e tij të tretë për Shqipërinë, ECRI rekomandoi që të merren një sërë nismash për të lehtësuar qasjen e fëmijëve romë dhe egjiptianë në të gjitha nivelet e arsimit dhe për të rritur pjesëmarjen e tyre.

<sup>17</sup> Raporti i Progresit për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Komunitetit Romë, faze 56.

52. Që nga raporti i tretë i ECRI, janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm në fushën e arsimit, veçanërisht si pjesë e zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Komunitetit Rom. Në lidhje me kushtet materiale të edukimit shkollor, veçanërisht përpjekje janë bërë, përmes iniciativave të ndryshme kombëtare dhe në disa raste të autoriteteve vendore, donatorëve ndërkombëtarë dhe organizatave lokale të shoqërisë civile, për të hapur dhe mbështetur kushtet për arsimin parashkollar nëpër zona ku ka numër të madh të fëmijëve romë. Mes viteve 2004 dhe 2006, sipas një skeme të përgjithshme për ndërtimin dhe rehabilitimin e shkollave në të gjithë vendin, qeveria shqiptare ka financuar rehabilitimin dhe ndërtimin e shkollave në lagjet ku komuniteti rom është shumicë, por megjithatë, deri tani nuk ekzistojnë të dhëna që të mundësojnë vlerësimin e ndikimit të këtyre masave mbi mundësitë e fëmijëve rom në arsim. Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka vënë në dukje se që nga viti 2008, ajo ka qenë e angazhuar në zhvillimin e një bazë të të dhënat mbi mundësitë për arsimim të fëmijëve romë dhe egjiptianë, në mënyrë për të vlerësuar ndikimin e masave të ndërmarra dhe për të orientuar politikat e ardhshme. Në vitin 2007, Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka zbatuar një politikë të re në lidhje me grantet për pajisje shkollore, ku prioritet i është dhënë projekteve që kanë për qëllim të ndihmojnë grupet e pafavorizuara, duke përfshirë edhe romët.
53. Masa të tjera konkrete janë të një natyre më shumë individuale. Për shembull, në vitin 2006, Ministria e Arsimit dhe Shkencës miratoi një qarkore<sup>18</sup> që përcaktonte se fëmijët romë mund të regjistrohen në shkollë edhe pa certifikata të lindjes; autoritetet kanë treguar se kjo masë ka mundësuar një përmirësim të konsiderueshëm në qytetet e prekura më rëndë nga përashtimi i fëmijëve romë nga shkolla, të cilët nuk janë regjistruar në regjistrin civil (Tiranë, Korçë, Durrës dhe Gjirokastër). Në mes të viteve akademike 2003-2004 dhe 2006-2007 autoritetet shpërndanë gjithashtu tekstet e nevojshme për vitet e shkollimit të detyrueshëm pa pagesë për fëmijët, prindërit e të cilëve janë të papunë, duke përfshirë edhe fëmijët romë. Nga 2007-2008, për të përmirësuar menaxhimin e këtyre granteve, një kontribut i vogël prej 10 për qind e çmimit ishte kërkuar për tekstet. Disa autoritete vendore kanë ndërmarrë nisma të veçanta që synojnë të lehtësojnë regjistrimin e fëmijëve romë në shkollë: për shembull, bashkia e Tiranës ka rritur kapacitetet e shkollave, ndërsa në të njëjtën kohë ka reduktuar kostot që lidhen me dërgimin e fëmijëve në shkollë për familjet e varfëra. Iniciativa të tillë nga autoritetet vendore gjithsesi mbeten të rralla dhe autoritetet shqiptare kanë deklaruar se ekziston nevoja e rritjes së numrit të këtyre iniciativave në të gjithë vendin.
54. Paralelisht me këto masa konkrete të mbështetjes, projekt "Shansi i dytë", i shkollës, ishte nisur në fund të vitit 2004 për të ndihmuar fëmijët që kishin braktisur shkollën, që ata të rifillonin shkollimit të tyre. Sipas informacionit të dhënë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, mbi 50 për qind e 469 nxënësve që marrin pjesë në këtë skemë i përkasin komunitetit<sup>19</sup> rom. Me qëllim që frika e gjetjes së vetes në një klasë me nxënës më të rinj të mos i dekurajojë fëmijët më të vjetër që të kthehen në shkollë, të ashtuquajturat klasa "kolektive" (të përbërë nga fëmijë të moshave të ndryshme) janë vendosur në disa shkolla pranë lagjeve të romëve. Gjithashtu, një numër Drejtorisë Arsimore Rajonale, kanë në plan të krijojnë klasa të veçanta që përgatisin nxënësit për t'u bashkuar me klasa të zakonshme. Përveç kësaj, shoqatat kombëtare rome dhe ndonjëherë autoritetet vendore, kanë bërë fushatë për të rritur ndërgjegjësimin e prindërve romë për rëndësinë e arsimit parashkollar, për të luftuar braktisjen

<sup>18</sup> Udhëzimi Nr. 6 i 29 Marsit 2006

<sup>19</sup> Raporti i Progresit për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Komunitetit Romë, faqe 28.

dhe për të inkurajuar prindërit për t'i dhënë prioritet edukimit të fëmijëve të tyre para hyrjes në tregun e punës. Këto përpjekje me gjithatë mbeten të shpërndara dhe pamjaftësisht të koordinuara; bashkëpunimi i përmirësuar është i nevojshëm për të rritur ndikimin e masave të marra nga palët përkatëse.

55. Autoritetet shqiptare kanë theksuar se, në sajë të një reformë globale të programeve shkolllore dhe në veçanti, mundësissë së futjes së mësimeve fakultative, mund të parashikohet mësimi i gjuhës rome në shkollat me një përqindje të lartë të nxënësve romë. Megjithatë, shumë pak mësues flasin këtë gjuhë dhe ata që kanë njojuri shpesh kanë vetëm njojuri bazë të saj. Ministria e Arsimit dhe Shkencës deri më tani nuk ka marrë aplikime për të kriuar klasa në gjuhën rome. Autoritetet shqiptare kanë treguar se Drejtoritë Rajonale të Arsimit rregullisht kanë drejtuar sesione trajnimi për edukimin ndërkulturor dhe jodiskriminues për të gjithë mësuesit që punojnë me komunitetin rom.
56. Në lidhje me qasjen e fëmijëve romë në shkollën e mesme dhe arsimin e lartë, nuk janë marrë hapa konkretë për të futur një sistem të granteve ose formave të tjera të mbështetjes për nxënësit romë që dëshirojnë të ndjekin studimet e tyre në nivel të mesém. Autoritetet kanë marrë shumë pak kërkesa për ndihmë në këtë drejtim, por tregojnë se ata i janë përgjigjur pozitivisht të gjitha kërkesave nga shoqatat rome dhe se, sa i përket arsimit të lartë, studentët romë mund të aplikojnë për grante, të cilat janë në dispozicion për të gjithë nxënësit nga familjet e varfra. Autoritetet kanë përmendur edhe iniciativat e fundit për krijimin e bursave të veçanta dhe kuotat për të mbështetur arsimimin e lartë të nxënësve rom; ECRI vë në dukje se këto të dhëna janë shumë me rëndësi, por e konsideron të parakohshme të analizojë ndikimin e këtyre iniciativave.
57. Autoritetet shqiptare nuk mbledhin në mënyrë sistematike të dhëna mbi situatën e fëmijëve në lidhje me arsimin dhe nuk kanë të dhëna të zbërthyera sipas grupeve etnike. Një studim i zhvilluar në vitin 2007 në mesin e rreth 5.000 fëmijëve romë të grupmoshave mes 3 dhe 16 vjeç dhe familjeve të tyre megjithatë ka zbardhur situatën. Sipas rezultateve të studimit, vetëm 13.5 për qind e fëmijëve romë mes të 3 dhe 5 vjeç vijojnë arsimin parashkollar dhe 46.5 për qind mes të moshës 6 dhe 16 vjeç vijojnë shkollën. Të dhënat varojnë dukshëm nga një rajon në tjetrin: në Kuçovë, rajon me shkallën më të ulët të braktisjes së shkollës, 26.5 për qind të fëmijëve romë mes të moshës 6 dhe 16 vjeç nuk e vijojnë shkollën; në Laç-Fushëkrujë, përqindja rritet në 90.30 për qind dhe në Peqin në 93.80 për qind<sup>20</sup> Përgjithësisht, ekziston një dallim prej 49.8 për qind mes shifrës së aplikimit të fëmijëve romë dhe jo-romë në moshën prej 7 deri në 15.<sup>21</sup> Nga mosha 14 për meshkujt dhe 11 për femrat, pothuajse gjysma e fëmijëve romë kanë braktisur shkollën. 54 për qind e fëmijëve romë mes të moshës 6 dhe 16 nuk kanë përfunduar me sukses një vit të vetëm akademik, dhe 43 për qind e adoleshentëve romë të moshës 15 dhe 16 janë analfabetë. Për më tepër, afér 70 për qind e fëmijëve romë nuk i kanë të gjitha tekstet shkollore dhe materialet tjera për studimet e tyre, afér 90 për qind nuk kanë vend të përshtatshëm në shtëpi për të bërë detyrat dhe 70 për qind theksojnë se prindërit e tyre nuk janë në gjendje t'i ndihmojnë.<sup>22</sup> Pas moshës minimale të braktisjes së shkollës, vetëm 12 për qind e romëve në moshën mes 16 dhe 19 vjeç vijojnë arsimin e mesém të lartë, krahasuar me një shifër prej 78 për qind për popullatën e mbetur, dhe vetëm 2 për qind e romëve shkojnë në shkollë të lartë.<sup>23</sup>

<sup>20</sup> Qendra për Zhvillim Njerëzor, Situata e Arsimit të Fëmijëve Romë në Shqipëri, Tiranë, 2007

<sup>21</sup> UNICEF, Çarja e Rrethit të Përjashtimit: Fëmijët Romë në Evropën Juglindore, Beograd, 2007 fq 50

<sup>22</sup> Qendra për Zhvillim Njerëzor, Situata e Arsimit të Fëmijëve Romë në Shqipëri, Tiranë, 2007

<sup>23</sup> UNICEF, Çarja e Rrethit të Përjashtimit: Fëmijët Romë në Evropën Juglindore, Beograd, 2007 fq.57

58. Janë raportuar raste të diskriminimit të drejtpërdrejtë racial në shkollë. Mbi 90 për qind e nxënësve romë kanë thënë se ata kanë qenë shënjestër e ofendimeve raciste në shkolla. Rreth gjysma e nxënësve romë raportojnë se ata janë dënuar më shpesh se të tjerët, dhe se mësuesit e tyre i thërrasin ata më rrallë në klasë dhe janë shpesh më pak të gatshëm për t'i ndihmuar ata.<sup>24</sup> Në disa raste, këto përvoja ushqejnë drejtpërdrejtë fenomenin e ashtuquajtur "mosvijueshmëri e fshehtë", një term i cili i referohet një situate ku nxënësit janë fizikisht prezent në klasë, por nuk kanë mundësi të ndjekin mësimet sepse nevojat e tyre arsimore nuk merren parasysh mjaftueshëm nga mësuesit e tyre.
59. Ashtu si e ka përmendur ECRI në raportin e tretë, një prej faktorëve që ndikon në mos regjistrimin e fëmijëve romë në shkolla është dështimi i regjistrimit të shumë fëmijëve në regjistrat civil. Masat e ndërmarra gjatë viteve të kaluara për ta lehtësuar procesin e regjistrimit civil janë dhënë më poshtë.<sup>25</sup> Përfaqësuesit romë thanë se, në disa raste, fëmijët të cilët kanë përfituar nga masat e fundit megjithatë janë refuzuar që t'i qasen shkollës mbi bazën se ata nuk janë vaksinuar: ECRI bënë të ditur se, edhe pse autoritetet janë në dijeni për këtë problematikë, çështja nuk duket se është zgjidhur plotësisht. Përfaqësuesit romë po ashtu nënvízojnë se vështirësitet sociale dhe ekonomike me të cilat përballen romët në Shqipëri, ndonëse të konsiderueshme, nuk lejojnë mjaftueshëm të sqarojnë problemet me të cilat ballafaqohen fëmijët romë në fushën e arsimit ose shkallën e braktisjes së shkollës; rëndësi duhet dhënë edhe njohjes së gjuhës shqipe, një fushë në të cilën mundësia për arsimin para shkollor është e një rëndësie kyçë.
60. Përsa i përket egjiptianëve shqiptarë, nuk është kryer asnjë studim i mundësisë së tyre për arsimim, dhe nuk janë marrë masa të veçanta. Komuniteti egjiptian vetraporton një numër problemesh në këtë fushë: edhe pse nuk ka dukshëm ndonjë fenomen masiv të braktisjes së shkollimit të detyrueshëm nga fëmijët egjiptianë, relativisht vetëm disa prej tyre i vazhdojnë studimet e tyre në shkollën e mesme dhe shumë më pak në shkollën e lartë, pasi që, për shkak të vështirësive ekonomike me të cilat ballafaqohet komuniteti, shumë të rinj egjiptianë fillojnë të punojnë që nga mosha 17 vjeç, ose edhe më herët. Ashtu si fëmijët romë, nxënësit egjiptianë shumë shpesh gjenden të ulur në fund të klasës; përveç kësaj, mësuesit në përgjithësi kanë pak njohuri në lidhje me specifikat e kulturës së egjiptianëve shqiptarë, dhe si pasojë nuk janë gjithmonë në pozitë që t'iu lehtësojnë këtyre nxënësve integrimin brenda klasës.
61. Nga pikëpamja e kësaj situate, dhe përkundër përpjekjeve të konsiderueshme të autoriteteve shqiptare në fushën e arsimit gjatë viteve të kaluara, ECRI nuk mund të mos përmendë që mundësitet e fëmijëve romë në arsim mbetet shumë të pakënaqshme. Në shkolla, fëmijët romë duhet të ballafaqohen me diskriminim të drejtpërdrejtë, dhe "mosvijueshmëri të fshehtë". Numri i fëmijëve romë që vijojnë shkollimin mbetet shumë më i ulët sesa për fëmijët që i takojnë shumicës dhe një numër i madh i fëmijëve romë braktisin shkollimin shumë para moshës minimale të mbarimit, të parashikuar nga ligji: duke folur në përgjithësi, rezultatet e tyre shkollore janë katastrofale dhe kjo ka një ndikim shkatërrues në zgjedhjet e tyre të ardhshme në jetë dhe mundësitet e punësimit. Braktisja e shkollës po ashtu i bënë ata më të prekshëm ndaj trafikimit.<sup>26</sup> Situata e fëmijëve egjiptianë në lidhje me sistemin e arsimit, edhe pse më pak e qartë pasi nuk ka pasur akoma ndonjë studim të detajuar mbi temën, po ashtu mbetet një arsyе për t'u shqetësuar.

<sup>24</sup> Ibid.

<sup>25</sup> Shih poshtë, Grupet e Prekshme/Synuara- Romët: Regjistrimi civil

<sup>26</sup>, Shih poshtë, Trafikimi I fëmijëve Romë dhe Egjiptian

62. ECRI rekomandon që autoritetet shqiptare të ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshëm për të siguruar që asnjë fëmijë nuk është përjashtuar nga shkolla për shkaqe administrative; në këtë drejtim ai rekomandon që ato t'i kushtojnë vëmendje të posaçme zbatimit të dispozitave që lejojnë regjistrimin në shkolla të fëmijëve romë edhe pa certifikata të lindjes, dhe i referohet në këtë kontekst rekomandimeve të tij të bëra diku tjeter në këtë raport në lidhje me regjistrimin civil.<sup>27</sup> Po ashtu, ai rekomandon që autoritetet shqiptare të sigurojnë se, nëse fëmija që vijon së pari shkollën nuk është vaksinuar, vaksinimi do t'i ofrohet në vend se t'i ndalohet shkolla fëmijës.
63. ECRI rekomandon që autoritetet shqiptare t'i shtojnë përpjekjet e tyre për ta rritur pjesëmarrjen e fëmijëve romë dhe egjiptianë në të gjitha nivelet e arsimit. Në këtë kontekst, ai thekson nevojën që të ruajë, dhe mundësishët të rrissë, përkrahjen financiare, masat përfshirë familjet më të pafavorizuara; të vazhdojë nën ngritjen e vetëdijes së prindërve për rëndësinë e dërgimit të fëmijëve të tyre në shkollë; të rekrutojnë dhe të trajnojnë mësues dhe drejtore shkollash me prejardhje romë dhe egjiptiane; të ofrojë trajnime të veçanta për mësuesit përfshirë vetëdijen e tyre për çështje të diskriminimit, dhe nevojat e fëmijëve romë dhe egjiptianë.
64. ECRI përsëri rekomandon që autoritetet shqiptare të jalin garanci përfshirë zbatimin e masave të shtjelluara në kuadër të Strategjisë Kombëtare përmirësimin e Kushteve të Jetës të Komunitetit romë në të gjitha fushat e arsimit. Ai nënizon rëndësinë e mundësimit të përfshirjes së organizatave rome në nivel vendor në zhvillimin dhe zbatimin e masave që i përshtaten nevojave të komunitetit të tyre.
65. ECRI rekomandon që autoritetet shqiptare, ta përshtypojnë krijimin dhe mbështetjen e funksionimit të lehtësirave parashkollore që t'i mundësojnë fëmijëve romë të përmirësojnë aftësitë në gjuhën shqipe para se të hyjnë në shkollë fillore; ai po ashtu i bën thirrje autoriteteteve shqiptare që ta përkrahin zbatimin e iniciativave joqeveritare që kanë dhënë rezultate të mira në këtë fushë.
66. ECRI përsëri rekomandon që autoritetet të sigurojnë se nuk ka diskriminim kundër fëmijëve romë dhe egjiptianë në shkolla.

## Punësimi

67. Sipas të dhënavëve më të reja të ofruara nga autoritetet shqiptare, shkalla e përgjithshme e papunësisë në Shqipëri është 13.1 përfshirë qind, por ajo është shumë më e lartë përfshirë popullsinë rome.<sup>28</sup> Afërsisht 9,000 personave të cilët janë të regjistruar si punëkërkues në Shqipëri, i përkasin grupeve të pafavorizuara rreth 3,000, ose një e treta, janë romë. Megjithatë, numri i romëve të papunë është në fakt shumë më i lartë, dhe ata vuajnë sidomos nga papunësia afatgjatë. Sipas autoriteteteve shqiptare, faktorët të tillë si: niveli i ulët i arsimit të popullsisë rome,<sup>29</sup> vendosja e tyre në rajonet më të varfër, dhe mungesa e efikasitetit të veprimeve të ndërmarrja, kanë kontribuar përfshirë këtë fenomen.<sup>30</sup>
68. Autoritetet shqiptare kanë bërë të ditur se nuk ka politika të veçanta përfshirë luftuar format e mundshme të diskriminimit që u adresohen romëve në fushën e punësimit; nga këndvështrimi ligjor, të gjithë ata të cilët i përkasin grupeve të

<sup>27</sup> Shih poshtë, Grupet e Prekshme/Synuara- Romët: Regjistrimi Civil

<sup>28</sup> Shih Raportin e Progresit mbi Zbatimin e Strategjisë Kombëtare përmirësimin e Kushteve te Jetës së Komunitetit Rome, fq. 43 Një Studim i Bankës Botërore i zhvilluar ne 2002, i cituar në ketë raport, ka dhënë një figure prej 71 përfshirë qind përfshirë papunësi në popullatën Rome në atë kohe, përderisa niveli kombëtar e papunësisë ka qene vetëm 15.8 përfshirë qind- Arsimi

<sup>29</sup> Shih lart, Diskriminimi në fusha të ndryshme - Edukimi

<sup>30</sup> Strategjia Kombëtare përmirësimin e Kushteve të Jetës së Komunitetit Rome, fq. 20

disfavorizuara gjëzojnë të drejta të njëjta të mbrojtjes dhe asistencës sociale dhe trajtohen njëloj. Sipas kësaj, romët mund të përfitojnë nga skemat e ndryshme të zbatuara, për shembull, në fushën e trajnimit profesional dhe udhëzimit nëse ata i takojnë njërit prej grupeve tanimë të identikuara, dhe me kusht që ata janë të regjistruar si të papunë. Disa iniciativa interesante të nivelit vendor janë ndërmarrë, por këto janë ende jo mirë të bazuara dhe nuk i adresojnë nevojat reale të komunitetit romë. Gjithashtu, ato ndonjëherë nuk i përshtaten kërkesave të tregut të punës. Duke folur në përgjithësi, autoritetet vendore, të cilat sipas Strategjisë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës të Komunitetit Romë duhet t'i ndihmojnë romët me integrimin e tyre në tregun e punës, rrallëherë kanë kryer një analizë të detajuar të situatës së punësimit të romëve të cilët i takojnë juridikSIONIT të tyre, edhe pse një qasje e tillë është e rëndësishme për skicimin dhe zbatimin e masave efektive.

69. Duke pranuar se komuniteti romë është larg të qenit grupi i vetëm i shqetësuar nga problemet e mundësisë për punësim në Shqipëri, ECRI i tërheq vëmendjen autoriteteteve shqiptare tek fakti se pabarazia serioze në mes të këtij minoriteti dhe pjesës tjetër të popullsisë, dhe nevoja për të tekaluar këto pabarazi tregon se politikat në këtë fushë duhet të forcohen. ECRI me keqardhje bënë të ditur këmbënguljen e autoriteteteve në barazinë formale në fushën e politikave të punësimit, edhe pse është fusha e vetme e jetës së përditshme në Shqipëri ku nevoja për ta luftuar diskriminimin racial së paku është pranuar përmes miratimit të dispozitiveve ligjore që ofrojnë mjete për viktimat individuale të diskriminimit. Për më shumë, ai rikujton se veprimet pozitive janë ndonjëherë të nevojshme për t'i rregulluar pabarazitë de facto.<sup>31</sup>
70. ECRI fuqimisht i inkurajon autoritetet që të shtojnë përpjekjet e tyre për përmirësimin e situatës së punësimit të komunitetit romë, dhe nënvizon se nga pikëpamja e natyrës së përgjithshme të disavantazheve që përfjetojnë romët në tregun e punës, masat specifike janë të domosdoshme për të eliminuar pabarazitë që përfjetojnë ata në mundësitë për punë.
71. ECRI rekomandon që autoritetet ta vlerësojnë periodikisht efektshmërinë e masave të ndërmarra për të përmirësuar situatën e punësimit të romëve, të rishikojnë sipas nevojës, sistemin e tyre për të monitoruar ndikimet e masave të ndërmarra, dhe nëse duhet, të marrin masa për të ngritur efektshmërinë e tyre.

## Shëndeti

72. Edhe pse disa statistika të detajuara ekzistojnë në fushën e shëndetësisë, në përgjithësi pranohet se komuniteti romë është në një situatë të pafavorshme në këto çështje, përfshirë gjendjen individuale shëndetësore dhe mundësitë për kujdes dhe trajtim. Sipas disa burimeve, jetëgjatësia e romëve është dhjetë vite më e ulët se e pjesës tjetër të popullatës. Vetëm 25 për qind e romëve deklarojnë se ata kanë të holla të mjaftueshme për të blerë barnat, në kontekstin kombëtar ku vetëm 39 për qind e popullatës ka ndonjë formë të mbulimit të sigurimit shëndetësor.<sup>32</sup> Janë ndërmarrë masa për të balancuar këto

<sup>31</sup> Shih po ashtu Gjykata e Përherershme e Drejtësisë Ndërkombëtare, Shkollat minoritare në Shqipëri, Opinion Këshillues 26, PCIJ, Ser. A/B, Nr. 64, 1935, ku Gjykata, duke iu referuar një opinioni të hershëm, ka thënë “ Duhet të ketë barazi në fakt, si dhe barazi ligjore sipërfaqësore në kuptimin e mungesës së diskriminimit në fjalët ee ligjit.barazia në ligj përfshin diskriminimit e çdo lloji”; ndonëse barazia në fakt mund të përfshijë nevojën e trajtimit të diferencuar me qëllim që të arrihet një rezultat që vendos një ekilibër mes situatave të ndryshme

<sup>32</sup> Shih Raportin e Progresit mbi Implementimin e Strategjisë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Komunitetit Romë, fq. 52, dhe Banka Botërore (2003), Vlerësimi i Varfërisë së Shqipërisë, fq. 76 i cituar në UNICEF, Çarja e ciklit të Përjashtimit: Fëmijët Romë në Evropën Juglindore, Beograd, 2007, fq. 31.

pabarazi, duke e bërë hartën e shpërndarjes gjeografike të vendbanimeve rome, dhe të qendrave të kujdesit shëndetësor në tërë Shqipërinë, dhe duke vendosur qendra shëtitëse të kujdesit shëndetësor me qëllim të arritjes të grupeve më të izoluara. Një program për të imunizuar fëmijët romë po ashtu është lançuar, i cili është i rëndësishëm jo vetëm për ta përmirësuar gjendjen shëndetësore të fëmijëve, por edhe për të lehtësuar pranimin e tyre në shkolla. Megjithatë, nuk janë vaksinuar të gjithë fëmijët romë,<sup>33</sup> dhe dyshimet lindin nëse fëmijët që nuk janë futur në regjistrat civilë do mund me të vërtetë të përfitojnë nga kjo skemë.

73. ECRI e mirëpret progresin e bërë, por vëren se është e vështirë në këtë fazë të vlerësohet ndikimi i masave të ndërmarrë në praktikë; nga informacionet ekzistuese, duket e qartë se këto përpjekje duhet të ndiqen.
74. ECRI fuqimisht inkurajon autoritetet shqiptare të vazhdojnë përpjekjet e tyre për të pakësuar pabarazitë në lidhje me statusin shëndetësor dhe mundësitë për kujdes shëndetësor në Shqipëri, dhe të monitorojnë rezultatin e këtyre masave te popullsia Rome nga pikëpamja e gjendjes shëndetësore të anëtarëve dhe mundësitë për kujdes shëndetësor dhe të marrin masa dhe të rrisin efikasitetin e tyre nëse është e nevojshme.

### **III. Dhuna raciste**

75. Në lidhje me dhunën raciste në Shqipëri, është vështirë të përfitohet një ide e saktë mbi situatën për shkak të mungesës së statistikave gjithëpërfshirëse mbi zbatimin e dispozitiveve përkatëse të Kodit Penal, dhe të dhënave të besueshme të ndara sipas grupeve etnike. Në mungesë të një informacioni të tillë, fatkeqësisht, nuk ka bazë të besueshme për ta bërë një vlerësim real të shpeshtësisë së incidenteve të dhunës raciale në Shqipëri, marrjen e masave efektive parandaluese kundër rasteve të tillë të dhunës, dhe luftimit të saj kur të shfaqet. Në lidhje me këtë, mund të thuhet se megjithëse aktet e dhunës raciste raportohet rrallë, kjo nuk do të thotë se vepra të tillë asnjëherë nuk ndiqen, meqë viktimat ndonjëherë hezitojnë të paraqiten ose të raportojnë aspekte raciste të një vepre penale sepse ndihen të turpëruar, frikësohen prej përsëritjes ose mendojnë se nuk do të ndërmeret ndonjë veprim serioz për këtë aspekt të ankesës së tyre.
76. ECRI rekomandon që autoritetet shqiptare të ndërmarrin hapa të nevojshëm për të zbatuar një sistem monitorimi të plotë, sistematik të të gjitha incidenteve që mund të kualifikohen si dhune raciste dhe, në lidhje me këtë, tërheq vëmendjen e tyre në Rekomandimet e veta për Politika të Përbashkëta Nr. 11 mbi luftimin e racizmit dhe diskriminimit racial në politikëbërje, në veçanti Pjesën III mbi rolin e policisë në luftimin e veprave raciste dhe monitorimin e incidenteve raciste. Në këtë kontekst, ECRI po ashtu i referohet rekomandimeve të bëra në pjesë të tjera të këtij rapporti në lidhje me monitorimin e situatës në çështjet e racizmit dhe diskriminimit racial.

### **IV. Racizmi në debatin publik**

77. Në reportin e tij të tretë, ECRI ka rekomanduar që autoritetet shqiptare t'ia bëjnë të njohur profesionistëve në media nevojën e miratimit të kodit të etikës për të luftuar raportimet që shkaktojnë racizëm, diskriminim dhe jo tolerancë.
78. Shqetësimi kryesor i ngritur nga të gjithë aktorët joqeveritarë në lidhje me mediat në Shqipëri është më shumë mungesa e pavarësisë të disa kanaleve kryesore televizive, sesa çështjet e debatit racist. Megjithatë, ECRI vëren me interes se një Kod i Etikës për mediat audiovizive është miratuar në vitin 2006, i

<sup>33</sup> Shih lart, Diskriminimi në fusha të ndryshme-Arsimi

cili mbulon, mes tjerash, nevojën e respektimit nga media të nevojave të çfarëdo lloji duke luftuar çdo forme të diskriminimit në bazë të gjinisë, racës, shtetësisë, gjuhës, besimit ose bindjeve. Ankesat në lidhje me shkeljet e parimeve të përcaktuara në Kod tani mund të parashtrohen në Këshillin mbi Etikën e Mediave; megjithatë është shumë herët për ECRI-in të vlerësojë ndikimin e Kodit të ri në funksionimin e mediave, dhe kompetencat e Këshillit që kanë të bëjmë me trajtimin e ankesave përsa u përket shkeljeve të pretenduara të dispozitave të Kodit lidhur me diskriminimin.

79. ECRI rekomandon që, duke mos ndërhyrë në pavarësinë e mediave, autoritetet shqiptare t'i inkurajojnë ato që të sigurojnë pajtueshmëri të plotë me standartet etike, të verifikojnë që Kodi i ri i Etikës përban masa efektive të luftimit të të gjitha formave të debatit racist në media, dhe nëse është e nevojshme t'i përforcojnë ato.

### **Qasja në Media**

80. Në raportin e tij të tretë, ECRI rekomandon që autoritetet shqiptare t'i informojnë mediat profesionale për nevojën që të përpilen t'ë jepin një mbulim të përshtatshëm të jetës së përditshme, problemeve dhe shqetësimet e anëtarëve të grupeve minoritare. ECRI po ashtu rekomandon që, anëtarëve të grupeve minoritare tu jepen mundësitet e duhura në mediat elektronike dhe të shtypura.
81. Disa grupe minoritare, siç janë minoritetet greke dhe maqedonase kanë mundësi në kanalet televizive, stacionet e radiove dhe mediat e shtypura në gjuhët e tyre amtare, por kjo nuk zbatohet për të gjitha grupet minoritare. Në lidhje me debatin, në/ose nga media me interes të përgjithshëm në Shqipëri, lidhur me grupet e ndryshme minoritare që jetojnë në vend, minoriteti rom dhe komuniteti egjiptian kanë mbulim të varfër nga mediat.
82. ECRI i inkurajon autoritetet shqiptare që të sigurojnë se të gjitha minoritetet dhe komunitetet që jetojnë në Shqipëri të kenë mundësi të shpërndarjes së informacioneve mbi kulturën e tyre në median publike.

### **V. Grupet e rrezikuara/Synuara**

83. Për të kuptuar situatat e larmishme të grupeve të ndryshme minoritare në Shqipëri, është me rëndësi të mbahen parasysh se ndërsa minoritetet grekë, maqedonas, dhe serbo-malazezët janë të njojur si "minoritete kombëtare", minoritetet rome dhe vllah/arumunë janë të njojur si "minoritete etno gjuhësore". Autoritetet nuk e kanë njojur komunitetin boshnjak si minoritet kombëtar, për më tepër, ata konsiderojnë që personat të cilët i takojnë komunitetit egjiptian nuk kanë një gjuhë të dallueshme ose shtetin e tyre, prandaj nuk mund të konsiderohen si minoritet.

### **Romët**

- *Regjistrimi Civil*

84. Në raportin e tretë, ECRI fuqimisht rekomandonte që autoritetet shqiptare të marrnin hapa për të lehtësuar në mënyrë të prekshme në veçanti përfshirjen e fëmijëve romë në regjistrin civil, në mënyrë që të gjithë fëmijët të ishin të regjistruar.
85. Që nga rapporti i tretë i ECRI-it, ndikimi i mos regjistrimit të fëmijëve në regjistrin civil në Shqipëri, në veçanti përsa i përket mundësitet të tyre për të drejtë sociale, janë përmendur në disa raste në raportet e organeve ndërkombëtare

dhe kombëtare.<sup>34</sup> Siç u përmend më lart,<sup>35</sup> në vitin 2006, Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka nxjerrë një qarkore që lejon fëmijët romë të regjistrohen në shkollë pa certifikatë lindjeje. Në vitin 2008, autoritetet shqiptare kanë ndryshuar legjislacionin që rregullon regjistrimin civil në mënyrë që të eliminojnë pengesat parësore të regjistrimit të fëmijëve jashtë afatit. Tani nuk kërkonet iniciimi i procedurës gjyqësore për regjistrimin e lindjes së fëmijës pas kalimit të periudhës ligjore, dhe gjobat nuk aplikohen për regjistrimin me vonesë. ECRI-it i është bërë e ditur se është krijuar një sistem i ri për të ofruar motive në vend për të dënuar; periudha e regjistrimit është zgjatur prej 45 në 60 ditë, dhe nëse lindja regjistrohet brenda 60 ditëve, familja fiton një bonus prej 5,000 lekë. Sipas informacioneve të ofruara nga autoritetet, falë dispozitave të reja, 6,926 fëmijëve iu është mundësuar regjistrimi gjatë periudhës 15 korrik dhe 15 shtatorit 2008.

86. ECRI i mirëpret këto masa të reja, të cilat duhet ta mundësojnë zgjidhjen e një numri të madh të rasteve. Megjithatë, a tërheq vëmendjen e autoriteteve për disa vështirësi të tjera të cilat mund të dalin, për shembull, në rastet e fëmijëve të lindur nga prindër të cilët as vet nuk janë regjistruar ndonjëherë, ose në rastin të kthimit nga jashtë të fëmijëve ende të paregjistruar në regjistrin civil të Shqipërisë të cilët e kanë lënë vendin pa dokumente identifikimi. ECRI po ashtu bënë të ditur nevojën për t'i informuar të gjithë aktorët përkatës për masat e reja në mënyrë që fëmijët mund të përfitojnë nga ato sa më shpejt që është e mundur, dhe kështu të gjelqjnë mundësinë e përmirësuar të të drejtave sociale, për shembull në fushën e arsimit dhe shëndetësisë. ECRI po ashtu është informuar për iniciativën e fundit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në kuadër të së cilës procedurat administrative dhe ligjore janë iniciuar me qëllim që të lejojnë romët (sidomos fëmijët) të cilët nuk janë regjistruar ende të përfshihen në regjistrin civil. ECRI shpreson se kjo iniciativë do të kontribuojë në mënyrë të ndjeshme në zgjidhjen e vështirësive që vazhdojnë në këtë fushë.
  87. ECRI fuqimisht inkurajon autoritetet shqiptare që të vazhdojnë përpjekjet e tyre në lidhje me regjistrimin e fëmijëve në regjistrin civil dhe iu bënë thirrje që të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që asnjë fëmijë i origjinës rome nuk mbetet pa dokumente identifikimi.
  88. ECRI rekomandon që autoritetet shqiptare të ndërmarrin informime dhe aktivitete për rritjen e vetëdijes së komunitetive rome, në bashkëpunim me përfaqësuesit e tyre dhe aktorët e tjere përkatës, në mënyrë që familjet e tyre të jenë të informuara rreth masave të reja në fuqi.
- *Implementimi i Strategjisë Kombëtare për Kushtet e Jetesës të Komunitetit Romë*
89. Në raportin e tretë, ECRI i ka nxitur autoritetet shqiptare që të sigurojnë se romët janë përfshirë drejtëpërdrejtë në të gjitha aspektet e zbatimit dhe vlerësimit të Strategjisë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës të Komunitetit Romë, përmes pjesëmarries së rregullt të anëtarëve të komunitetit rom dhe organizatave të ndryshme rome aktive në nivel vendor.
  90. Shumë masa të zbatuara sipas Strategjisë, përshkruhen në pjesë të tjera të këtij reporti.<sup>36</sup> Njësia përgjegjëse për Monitorimin e Zbatimit të Strategjisë, e

<sup>34</sup> Shih, për shembull, Komiteti mbi të Drejtat e Fëmijëve, Observimet Përfundimtare: Shqipëri , CRC/C/15/Add.249, 31 mars 2005; Komiteti Këshillues për Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Opinion I dytë mbi Shqipërinë, ACFC/OP/II(2008)003, I adoptuar me 29 maj 2008; Raportet vjetore të aktivitetit të Avokatit të Popullit Shqiptar.

<sup>35</sup> Shih lart, Diskriminimi në fusha të ndryshme- Arsimi

<sup>36</sup> Shih, inter alia, seksionet mbi Diskriminimin në Fusha të Ndryshme – Strehimi, – Arsimimi, – Punësimi, – Shëndeti.

krijuar në vitin 2004, i është bashkangjitur drejtpërdrejtë Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe tani ka dy punonjës, përfshirë një romë. Njësia është e ngarkuar me vendosjen dhe mbajtjen e kontakteve me autoritetet kombëtare dhe vendore të përfshirë në zbatimin e Strategjisë dhe bashkëpunimin me organizatat përkatëse ndërkombëtare dhe shoqërinë civile në fushë, në veçanti OJQ-të rome. Si pjesë e aktiviteteve të saj që kanë synuar të garantojnë se kjo Strategji do të merret parasysh nga të gjitha palët e interesuar dhe se do të zbatohet në praktikë, njësia ka organizuar fushata informuese dhe sesione diskutimesh në tryeza të rrumbullakëta; njësia po ashtu ka përmendur se, që kur Shqipëria i është bashkangjitur Dekadës së Përfshirjes së Romëve në vitin 2008, rrjeti i vet i bashkëpunimit është fuqizuar. Gjithashtu, njësia monitoruese i ka kushtuar rëndësi përpjekjeve për fuqizimin e kapaciteteve monitoruese. Ndërkohë, autoritetet shqiptare kanë theksuar se puna është në progres lidhur me miratimin e një plani kombëtar të veprimit në kontekstin e Dekadës së Përfshirjes së Romëve.

91. Megjithë këto përpjekje, përfaqësuesit romë theksuan se politikat e paraqitura në Strategji nuk janë ndjekur sa duhet. Disa përfaqësues shprehin qëndrimin se raporti i progresit mbi Zbatimin e Strategjisë, i publikuar në dhjetor 2007 paraqet më shumë një përsëritle të mërzitshmë të keqardhjeve se sa një përshkrim të arritjeve Njësia përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të Strategjisë ende ka burime të vogla krahasuar me ngarkesën e punës të krijuar nga Strategja. Autoritetet kanë thënë se përpjekjet janë në rrugë e sipër, përmes krijimit të një grupei pune ndërministror, për t'i dhënë ndikim më të madh punës së ministrive të ndryshme të përfshira në zbatimin e Strategjisë, dhe përmirësimin e koordinimit të tyre; ECRI shpreson se këto përpjekje do të jalin shumë shpejt fryte.
92. ECRI vëren me interes të veçantë qasjen kritike të adoptuar në Raportin e Progresit mbi Zbatimin e Strategjisë dhe e konsideron se një qasje e tillë është e nevojshme për tu përballur me vështirësitë dhe që gjërat të shkojnë përrapa. Gjithashtu, raporti përmend se zbatimi i dy politikave të ndërmarrë në nivel kombëtar dhe projektet e përkrahura nga komuniteti ndërkombëtar shumë shpesh varen nga vullneti i mirë i autoriteteve vendore dhe mbi iniciativat e marra nga këta të fundit; nga pikëpamja e shkallës së problemeve me të cilat ballafaqohen romët, ECRI konsideron se mund të jetë ndihmë për autoritetet kombëtare fuqizimi jo vetëm i burimeve të njësisë së monitorimit, por edhe mjetet e përdorura nga autoritetet vendore që të marrin pjesë në zbatimin e konkret të Strategjisë.
93. ECRI rekomandon që autoritetet shqiptare të ndjekin dhe të intensifikojnë përpjekjet e tyre për të siguruar zbatimin në praktikë të Strategjisë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës të Komunitetit Romë. Në këtë drejtim, ai rekomandon që ata të konsiderojnë masat që mundësojnë autoritetet kombëtare të ndërmarrin veprime përtëj kufizimeve të rolit të tyre tradicional vendimmarrës dhe koordinues, në mënyrë që të detyrojnë autoritetet vendore të mbajnë parasysh priorititet e përcaktuara në Strategji.
94. ECRI i inkurajon autoritetet shqiptare që ta forcojnë sistemin për të dhënë prioritet projekteve vendore që synojnë përmirësimin e situatave të diskriminimit direkt kur t'i ndajnë grantet kombëtare dhe të parashikojnë si të detyrueshme marrjen parasysh të këtij prioriteti në aplikimin e granteve dhe procedurave të fitimit.
95. ECRI rekomandon që autoritetet shqiptare të vazhdojnë të fuqizojnë resurset e shpërndara për të monitoruar zbatimin e Strategjisë në mënyrë që të gjitha ministritë dhe autoritetet në fjalë, dhe përfaqësuesit romë të janë aktivisht të përfshirë në të gjitha shkallët e procesit të implementimit.

## Egjiptianët Shqiptarë

96. Në raportin e tretë, ECRI i ka nxitur autoritetet shqiptare që të sigurojnë se parimet e mosdiskriminimit respektohen plotësisht në lidhje me egjiptianët në Shqipëri, në veçanti përsa i përket pjesëmarrjes së tyre dhe mundësisë që institucionet zyrtare shtetërore që merren me nevojat dhe shqetësimet e minoriteteve të vendit, e në veçanti në Komisionin Shtetëror për Minoritete. ECRI rekomandon që autoritetet shqiptare t'i përkushtojnë vëmendje të veçantë problemeve me të cilat ballafaqohet komuniteti egjiptian dhe të zhvillojnë, në bashkëpunim me këto komunitete, masa që synojnë nevojat e tyre të veçanta.
97. 97 ECRI verën se situata e komunitetit egjiptian ka ndryshuar shumë pak që nga raporti i tretë. Kërkesa e komunitetit për tu njojur si minoritet dhe për t'iu dhënë një vend atyre në organe të tillë si Komiteti Shtetëror për Minoritetet vazhdon të refuzohet nga autoritetet, të cilët argumentojnë se ekzistenza e një shteti amë dhe një gjuhe specifike janë elementë të qenësishëm pa të cilat një komunitet nuk mund të njihet si një minoritet kombëtar ose "etniko-gjuhësor". Përderisa Komiteti Shtetëror për Minoritetet ka bërë të ditur gatishmërinë e vet për t'a kushtuar tërë vëmendjen shqetësimeve dhe interesave të komuniteti egjiptian, pavarësisht faktit se nuk ka anëtar egjiptian shqiptar në Komitet, kjo shihet si një zgjidhje më e mirë e përkohshme. Insistimi i autoriteteve se nuk është e mundur që të njihet komuniteti egjiptian si minoritet e fuqizon ndjenjën e përjashtimit mes egjiptianëve shqiptarë, të cilët, edhe pse pohojnë kulturën dhe identitetin e tyre të veçantë, nuk kanë mundësi të njëjtë për t'i ruajtur dhe promovuar ato siç i janë akorduar dhe njojur minoritetëve. Nga këto këndvështrime, egjiptianët ankohen se janë përjashtuar nga jeta politike e vendit dhe nga garantimi i minimumit të mbulimit mediatik për ta bërë të njojur më shumë kulturën e tyre.
98. Për më tepër, edhe pse është përgjithësisht e njojur se rrethanat ekonomike dhe sociale të egjiptianëve i vendosin ata në një disavantazh më të madh se sa shumica e popullsisë dhe se ata shumë shpesh jetojnë në varfëri, shumë pak të dhëna janë mbledhur për këtë. Nuk ka informacion të saktë mbi situatën e egjiptianëve shqiptarë në lidhje me mundësitë në strehim, arsim, tregun e punës dhe kujdesin shëndetësor, sikurse nuk ka asnje strategji të përgjithshme që përpinqet t'i adresojë këto probleme.
99. ECRI i rekomandon fuqimisht autoriteteteve shqiptare që të sigurojnë se egjiptianët shqiptarë nuk janë viktima të diskriminimit në lidhje me pjesëmarrjen dhe mundësitë që institucionet publike që merren me nevojat dhe shqetësimet e minoriteteve të vendit. Në këtë drejtim, ai rekomandon që ata të fuqizojnë dialogun me komunitetin egjiptian në mënyrë që të identifikojnë zgjidhje që u mundëson atyre të luajnë një rol aktiv në vendimet që i përkasin atyre dhe të nxisë njohuri të përmirësuara të kulturës dhe identitetit të tyre.
100. ECRI përsëri rekomandon që autoritetet shqiptare t'i kushtojnë rëndësi të veçantë problemeve me të cilat ballafaqohet komuniteti egjiptian, të kryejnë studime të thella mbi këtë temë dhe të zhvillojnë, në bashkëpunim me egjiptianët shqiptarë, masa që synojnë nevojat të tyre të veçanta, përfshirë masa që adresojnë çfarëdo diskriminimi jo direkt ose racizmin që ata e përjetojnë. Siç është përmendur në raportin e tretë të ECRI, autoritetet shqiptare mund të konsiderojnë miratimin e një strategjie specifike kombëtare që synon përmirësimin e situatës së egjiptianëve në Shqipëri.

## **Minoritetet Greke, Maqedonase, Sérbo-Malazeze dhe Vllahë-Arumunë; komuniteti Boshnjak**

101. Siç është përmendor më lart,<sup>37</sup> në Shqipëri minoritetet greke, maqedonase dhe serbo-malazeze kanë statusin e “minoritetit kombëtar”: minoriteti vllah/arumunë, njihet si minoritet “etniko-gjuhësor” per faktin se, ashtu si minoriteti romë, ai nuk konsiderohet se ka një shtet amë. Përfaqësuesit e minoritetit vllah/arumunë kanë thënë se ky dallim në përcaktim, i bazuar mbi një kriter objektiv, fatkeqësisht rrezikon brenda këtij minoriteti një ndjenjë të fuqishme se ata trajtohen si inferiorë dhe krijon përshtypjen se janë lënë vetëm si identite gjuhësorë. Sipas autoriteteve, fakti që minoriteti është njohur si minoritet kombëtar ose një minoritet etniko-gjuhësor nuk ka të bëjë aspak me fushëveprimin e të drejtave që i njihen atij. ECRI tërheq vëmendjen e autoriteteve mbi faktin se mënyra në të cilën është përcaktuar grupi mund, megjithatë, të ketë një ndikim të konsiderueshëm në ndjenjën e identitetit të anëtarëve.
102. Boshnjakët nuk njihen si një minoritet në Shqipëri. Ata thonë se ata janë të integruar në shoqëri sikurse grekët, maqedonasit, sérbo-malazezët dhe vllah/arumunët dhe dëshirojnë të përfitojnë nga niveli i njëjtë i njohjes ligjore si minoritet tanimë të njohura, dhe në veçanti nga mundësitet e njëjta në arsimin në gjuhën e tyre amtare.
103. ECRI thotë se legjislacioni i cili garanton arsimimin në gjuhën minoritare është miratuar dhe se ka klasa ku mësohet në gjuhën greke dhe maqedonase. Autoritetet kanë pohuar se është kërkuar hapja e klasave ose shkollave që lejojnë arsimin në gjuhët minoritare jo vetëm në zonat nga një numër i madh i njerezve që i takojnë këtyre minoritetet, por edhe në qytetet e mëdha siç janë Tirana. Nën legjislacionin përkatës, në nivelin e shkollës filllore, 90 për qind e lëndëve mësohen në gjuhën minoritare dhe 10 për qind në shqip; përqindjet pastaj gradualisht zvogëlohen derisa në vitin e nëntë dhe të fundit të shkollimit të detyruar 60 për qind e lëndëve mësohen në gjuhët minoritare, kurse 40 përqind në shqip. Përfaqësuesit e minoritetet e ndryshme megjithatë tërheqin vëmendjen te një numër problemesh, për shembull, vështirësitë e pasjes së teksteve shkollore në gjuhët minoritare ose mungesa e gatishmërisë së zbatimit nga autoritetet arsimore në nivel rejonal të urdhëresave të lëshuara nga Ministria; disa minoritete konsiderojnë se këto rregulla ekzistuese nuk i përgjigjen plotësisht nevojave të tyre.
104. Në prill 2009, në cilësinë e përfaqësuesit të autoritetet publike, një kryetar komune i cili i takonte një minoriteti kombëtar u dënuar në shkallë të parë me 6 muaj heqje lirie, një gjobë prej 500,000 Lek dhe ndalesë tre vjet të mbajtjes së postit publik për shkak se ka urdhër për heqjen e shenjave rrugore në gjuhën shqipe, mbi bazat se ato nuk ishin shkruar edhe në gjuhën minoritare të folur nga një numër i madh i banorëve të rajonit. ECRI thotë se ky vendim nuk është përfundimtar pasi kryetari i komunës ka deklaruar se planifikon ta ankimojë atë. Pavarësisht rezultatit të këtij rasti, ECRI tërheq vëmendjen e autoritetet shqiptare në faktin se një sqarim në lidhje me dispozitat ligjore që rregullojnë përdorimin e treguesve topografikë në gjuhët minoritare në Shqipëri do të mund t'i kontribuonte marrëdhënieve të mira mes të minoritetet e ndryshme dhe shumicës së popullsisë; ai i referohet përfundimeve të Komisionit Këshillues mbi Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Minoritetet Kombëtare në lidhje me këtë temë.<sup>38</sup>

<sup>37</sup> Shih më lartë, organet dhe institucionet tjera kundër diskriminimit – Komiteti Shtetëror për Minoritetet

<sup>38</sup> Komiteti Këshillues i Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Opinion I Dytë mbi Shqipërinë, ACFC/OP/II(2008)003, i adoptuar me 29 maj 2008, vrojtimet në lidhje me Nenin 11

105. ECRI i rekomandon autoriteteteve shqiptare të forcojnë dialogun e tyre me përfaqësuesit e minoritetit vllah/arumun dhe me boshnjakët që jetojnë në Shqipëri në mënyrë që të identifikojnë zgjidhje që e bëjnë të mundur marrjen parasysh më të mire të kërkesave të tyre specifike.
106. ECRI i inkurajon fuqimisht autoritetet shqiptare që të vazhdojnë përpjekjet e tyre për promovimin e arsimit në gjuhët minoritare, në lidhje me këtë, i inkurajon ata të forcojnë dialogun me përfaqësuesit e grupeve të ndryshme minoritare në mënyrë që të gjejnë zgjidhje më të mira në çdo rast.

### **Imigruesit, refugjatët dhe azil kërkuesit**

107. Në raportin e tretë, ECRI ka rekomanduar që autoritetet Shqiptare të vazhdojnë të ndërmarrin hapa të nevojshme me qëllim të marrjes së përgjegjësisë së plotë për procedurat e azilit. Ai po ashtu i ka inkurajuar autoritetet shqiptare që të sigurojnë se zyrtarët publikë kanë vazhduar të ndjekin trajnime në lidhje me procedurat e azilit dhe të drejtat e azilkërkuesve. Gjithashtu, ai ka rekomanduar fuqimisht që autoritetet shqiptare të jenë në harmoni me parimin e mosriatëdhesimit dhe se personave që kanë nevojë për mbrojtje dhe ndihmë ndërkombëtare tu jepet mundësia e duhur. Në lidhje me këtë, ai i ka rekomanduar autoriteteteve shqiptare që ta zgjerojnë procedurën e para kualifikimit në zonat e kufirit dhe përbri “zonat tampon” sa më shpejtë që është e mundur.
108. Shqipëria pranon disa kërkesa për azil: sipas të dhënave të ofruara nga autoritetet, 18 kërkesa janë parashtruar në 2005, 11 në 2008, 27 në 2007 dhe 13 në 2008. Aplikimet ekzaminohen në shkallë të parë nga Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët në Ministrinë e Punëve të Brendshme, vendimet e të cilët janë të hapura për ankesë gjyqësore. Megjithatë, ECRI u informua, se largimi i madh i personelit përgjegjës për procedurat e azilit dhe mungesa e një specialisti ligjor brenda Drejtorisë për Shtetësinë dhe Refugjatët në disa raste kanë vështirësuar funksionimin e duhur të sistemit. ECRI vëren me interes informacionin e ofruar nga autoritetet se një specialist ligjor është emëruar rishtazi brenda Drejtorisë dhe shpreson se ky emërim do të kontribuojë në përmirësimin e funksionimit të sistemit të azilit.
109. Autoritetet shqiptare kanë marrë përgjegjësinë e procedurës së para-kualifikimit, i cili përpara është kryer nga UNHCR, duke filluar nga prilli 2006. Qëllimi i kësaj procedure është identifikimi i personave në nevojë për ndihmë dhe mbrojtje ndërkombëtare (azilkërkuesit, viktimat e trafikimit etj.) pas ardhjes në kufi dhe i referojnë ata në procedura të duhura sa më shpejt që është e mundur. Njëmbëdhjetë qendra të përkohshme të pritjes të vendosura afër kufijve të vendit janë rinnovuar, dhe i është dhënë përkrahje Qendrës Kombëtare për Azil-Kërkuesit në Babrru. Sesione trajnuese janë mbajtur për zyrtarë të migrimit dhe policinë kufitare për të ngritur ndërgjegjësimin e tyre në lidhje me çështjet e të drejtave të njeriut të cilat mund të dalin, në veçanti me parimin e mos riatiëdhesimit, dhe për t'i ndihmuar ata në zotërimin e këtyre procedurave të reja. Megjithatë, ndërrimet shumë të shpeshta të personelit kanë treguar të kenë efekt negativ në zbatimin efektiv të procedurave të parakualifikimit.
110. Të gjithë azilkërkuesit të cilët nuk kanë burime të mjaftueshme për tu kujdesur për nevojat e veta janë akomoduar në Qendrën Kombëtare për Azilkërkues në Babrru. Legjislacioni në fuqi i jep personave me status të njohur të refugjatit një numër të drejtrash në pajtim me Konventën e Gjenevës, jo më pak se e drejta në arsim, e drejta në punë, të drejtat në mbrojtje sociale dhe strehim dhe e drejta e ribashkimit familjar. Megjithatë, nuk janë adoptuar akoma të gjitha instrumentet e nevojshme ligjore ose rregullues për zbatimin e këtyre dispozitave.

111. ECRI rekomandon që autoritetet shqiptare të miratojnë sa më shpejt që është e mundur instrumentet ligjore ose rregullues të nevojshëm për funksionimin e duhur të sistemit të azilit në Shqipëri, duke siguruar respektim të plotë për të drejtat e azilkërkuesve.
112. ECRI fuqimisht i inkurajon autoritetet shqiptare që të zhvillojnë trajnimet dhe përpjekjet e tyre për rritjen e ndërgjegjësimit në lidhje me migrimin dhe policisë kufitarë, në mënyrë që të sigurojnë se të gjithë zyrtarët në fjalë të zotërojnë procedurat e reja të parakualifikimit dhe të janë në gjendje të plotë për të garantuar respektimin e të drejtave të njeriut dhe parimin e mos-riatëdhësimit. Në lidhje me këtë, ai po ashtu rekomandon që autoritetet shqiptare t'i japid rëndësi të plotë arsyeve për largimin e madh nga puna të raportuar të statit që punon në fushën e azilit dhe migrimit dhe të marrin të gjithë hapat e nevojshëm për të siguruar se zyrtarët e rinj mund të janë plotësisht operacional brenda një kohe të shkurtër.

## **VI. Margjinalizimi dhe Neglizhimi i Romëve dhe Egjiptianëve**

113. Në raportin e tretë, ECRI u ka rekomanduar autoriteteteve shqiptare që t'i analizojnë mënyrat në të cilat romët ose egjiptianët mund të kenë përvaja me format e diskriminimit jo direkt në fusha të ndryshme të jetës, dhe të vlerësojnë ndikimin e stereotipave dhe paragjykimeve të rrezikshme kundrejt këtyre grupeve minoritare. Gjithashtu, ai ka rekomanduar që ata të ndërmarrin hapa për të siguruar se komunitetet romë dhe egjiptianë nuk janë të diskriminuar përmes neglizhencës nga vendimmarrësit dhe zyrtarët e tjera publikë, dhe ka theksuar se masat e synuara mund të janë të nevojshme për të siguruar se komunitetet romë dhe egjiptiane përfitojnë nga barazia në praktikë.
114. ECRI vëren se, që nga raporti i tretë, masa të shumta janë marrë ose sipas Strategjisë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Komunitetit Romë, ose në ndonjë kontekst më të përgjithshëm të masave për luftimin e varfërisë dhe përjashtimit shoqëror. Përkundër këtyre masave, ECRI mbetet thellësisht i shqetësuar në lidhje me varférinë ekstreme dhe margjinalizimin social dhe ekonomik të një numri të madh të romëve dhe egjiptianëve në Shqipëri. Siç është përmendur më lartë,<sup>39</sup> shumë prej tyre jetojnë në kushte të pasigurta, në vendbanime të cilat janë shpesh pa mundësi të pasjes së ujit të pijshëm, energji elektrike dhe rrjeteve të kanalizimeve, dhe në zona ku akoma ka një kujdes shëndetësor të kufizuar. Krahas nivelit ekstremisht të lartë të papunësisë, shkalla e braktisjes së shkollës mga fëmijët romë mbetet në veçanti katastrofale, duke i bërë ata shumë të rrezikuar për tu bërë viktima të trafikimit. Ndërsa probleme të tillë ekzistojnë edhe në segmentet e tjera të popullsisë shqiptare, romët dhe egjiptianët qartazi përfjetojnë situata të tillë të disavantazhit ekstrem në një shkallë jo-proporcionale. Përveç kësaj, indiferenca në drejtim të këtyre komuniteteve e treguar nga disa politikanë, sidomos në nivel vendor, dhe përfaqësimi i dobët i tyre në jetën politike dhe publike të vendit e rëndon margjinalizimin e tyre dhe pengon zgjidhjen e problemeve me të cilat ata duhet të ballafaqohen.
115. Që nga raporti i tretë i ECRI-s, është zhvilluar një studim i thellë i situatës së arsimit të fëmijëve romë në Shqipëri<sup>40</sup> dhe ka treguar se jo vetëm që ata vuajnë nga diskriminimi de facto, por ata gjithashtu ndikohen edhe nga pasojat e paragjykimit dhe faktorë të tjera rëndues. Megjithatë, ky studim mbetet një iniciativë e izoluar; në përgjithësi, ekzistojnë akoma shumë pak të dhëna të qarta në lidhje me diskriminimin jo direkt ose ndikimin e stereotipeve negativë mbi situatën e romëve dhe egjiptianëve. Sikurse edhe gjatë vizitës së

<sup>39</sup> Shih lartë, Diskriminimi në Fusha të Ndryshme- Strehimi, - Arsimi- Punësimi- Shëndetësia

<sup>40</sup> Qendra për Zhvillim Njerëzor, Situata Arsimore e fëmijëve Romë, Tiranë, 2007.

mëparshme të ECRI-it, përfaqësuesit e autoritetet shqiptare në shumë raste kanë theksuar se, sipas ligjit shqiptar, të gjithë qytetarët janë të barabartë prandaj për këtë arsyesh romët dhe egjiptianët kanë mundësi të njëjtë si çdo qytetar tjetër ku flitet për mundësitë e të drejtave sociale ose ndonjë sektor tjetër të jetës; më tej, përfundimi ishte theksuar në mënyrë të shpeshtë. Ç'ka nënkupton se nuk ka diskriminimin në shoqërinë shqiptare. ECRI vë në dukje fuqimisht se, nga pikëpamja e rrëthanave të ndryshme të grupeve të ndryshme, vetëm barazia formale ose neutraliteti i legjislacionit nga ana e tij nuk janë gjithmonë të mjaftueshme për tu garantuar grupeve të ndryshme mundësi të barabarta të të drejtave të njëjtë. Për të rregulluar pabarazitë de facto, ndonjëherë nevojiten veprime pozitive. Edhe pse Strategjia Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Komunitetit Romë përkon me këtë logjikë, vështirësitet që lindin në zbatimin e saj<sup>41</sup> janë padyshim të lidhura, së paku pjesërisht, me mos interesimin për një veprim të tillë të treguar nga shumë nga ata që preken nga kjo, përfshirë edhe aktorët kyç.

- 116. ECRI nënizon se, nga pikëpamja e situatës së veçantë disfavorizuese të anëtarëve të komuniteteve romë dhe egjiptianë, problemet me të cilat ata duhet të merren nuk mund të zgjidhen brenda natës, por do të kërkojnë përpjekje afatgjatë. Në këtë kontekst, është me rëndësi që të gjithë aktorët në fjalë ta kuptojnë qartë se ajo çka është e mundur është mundësia e romëve dhe egjiptianëve të marrin pjesë në shoqërinë shqiptare në mënyrë të barabartë, një mundësi që për momentin ata e kanë të mohuar përkundër neutralitetit të dukshëm të legjislacionit në fuqi. Është me rëndësi të njëjtë që situata e tyre dhe ndikimi i masave të ndërmarrë duhet të monitorohen në baza të rregullta. Është domosdoshme, së pari, të lejohet miratimi i masave të duhura të synuara, dhe së dyti, të tregohet se nga popullësia e shumicës dhe komunitetet rome dhe egjiptiane se progresi ndonëse domosdoshmërisht i ngadalshëm është me të vërtetë duke u bërë.<sup>42</sup>
- 117. ECRI ripërsërit rekomandimin e tij për autoritetet shqiptare që të analizojnë mënyrat në të cilat romët dhe egjiptianët mund të përfjetojnë forma të diskriminimit jo direkt në fusha të ndryshme të jetës. Ai përsëri thekson se masat e synuara mund të nevojiten në mënyrë që të sigurohet se komunitetet rome dhe egjiptiane të përfitojnë nga barazia në praktikë dhe i nxitë autoritetet të parashohin marrjen e masave të tillë sa herë që është e nevojshme.
- 118. ECRI nxit vendimmarrësit kombëtarë dhe lokalë si dhe zyrtarët e tjera që të sigurojnë si i është dhënë vëmendje e duhur problemeve të veçanta dhe nevojave të këtyre komuniteteve në të gjitha fushat e jetës dhe të garantojnë përfshirjen e tyre të plotë në jetën ekonomike, sociale dhe politike të vendit.
- 119. ECRI rekomandon përsëri që autoritetet shqiptare të zhvillojnë një hetim mbi stereotipet dhe paragjykimet ndaj këtyre grupeve minoritare dhe të konsiderojnë marrjen e masave të drejtuara për të luftuar stereotipe dhe paragjykime të tillë.

## VII. Pjesëmarrja e Minoriteteve në Jetën Publike

### Pjesëmarrja në vendim-marrje politike

- 120. Në raportin e tretë, ECRI rekomandonte që autoritetet shqiptare të marrin masa për të siguruar se grupet minoritare, përfshirë romët dhe egjiptianët, janë të regjistruar në mënyrë të efektshme për të votuar dhe përfaqësuar brenda organeve politike vendimmarrëse në nivel kombëtar dhe vendor.

<sup>41</sup> Shih lartë, Grupet e Rrezikuara/Synuara- Romët: Zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Komunitetit Romë.

<sup>42</sup> Çështja e pjesëmarrjes së minoriteteve në vendimet që i prekin ata është trajtuar më poshtë; shih Pjesëmarrja e Minoriteteve në Jetën Publike.

121. Legjislacioni që rregullon regjistrimin në listat e votuesve dhe përfaqësimin e minoriteteve në Kuvendin e Shqipërisë është diskutuar më lart.<sup>43</sup> Në lidhje me përfaqësimin e minoriteteve në organet politike vendimmarrëse në nivel vendor, ECRI vëren se situata dallon në mënyrë të konsiderueshme në varësi se për cilin minoritet bëhet fjalë. Për shembull, personat që i takojnë minoritetit grek mbajnë poste si kryetar komune ose prefekt rajonal në zonat e Shqipërisë ku është përqëndruar minoriteti grek; anëtarët e komunitetit boshnjak kanë qenë gjithashtu të zgjedhur në këshillat bashkiakë të tyre. Megjithatë, në lidhje me romët dhe egjiptianët, nuk ka ardhur asnjë informacion që e mohon analizën e bërrë nga ECRI në raportin e tij paraprak se këto grupe janë të papërfaqësuara në organet politike vendimmarrëse, edhe në komunat dhe rajonet ku romët dhe egjiptianët përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të popullsisë; këto grupe minoritare janë rrjedhimisht në pozitë të keqe për të mbrojtur interesat e veta në nivel politikë. ECRI përsërit se mospërfaqësimi politikë i romëve dhe egjiptianëve- pjesërisht për shkak të një mungese të besimit në partitë politike në mesin e anëtarëve të këtyre grupeve minoritare dhe ndjenjës se partitë nuk i përfaqësojnë interesat e këtyre grupeve – mund të shërbejnë për forcimin e marginizimit të romëve dhe egjiptianëve, dhe neglizhencës prej së cilës vuajnjë.
122. ECRI rekomandon përsëri që autoritetet Shqiptare të marrin masa që të rrisin pjesëmarrjen e romëve dhe egjiptianëve në proceset politike në nivel vendor dhe të sigurojnë që grupet minoritare, përfshirë romët dhe egjiptianët, janë të përfaqësuar efektivisht brenda organeve politike vendimmarrëse në nivel vendor.

### **Perfaqësimi ne institucionet shtetërore**

123. Në raportin e tretë, ECRI i ka rekomanduar autoriteteteve shqiptare që të ndërmarrin hapa përritjen e përfaqësimit të personave që i përkasin grupeve të ndryshme minoritare të vendit brenda institucioneve shtetërore, përfshirë shërbimin publik, ushtrinë, gjyqësorin dhe policinë, në nivel kombëtar dhe vendorë.
124. Autoritetet kanë informuar sërisht ECRI-in se nuk ka pengesa formale të cilat do të vështirësonin pjesëmarrjen e personave që i përkasin grupeve minoritare në institucionet shtetërore; në lidhje me këtë, ata, gjithashtu, kanë argumentuar për shembull se një numër shumë i vogël i oficerëve të policisë me origjinë rome nuk mund të jetë rezultat i çfarëdo forme të diskriminimit, sepse rregullat dhe procedurat për tu bërrë pjesë e policisë janë të hapura dhe janë të njëjtë për të gjithë qytetarët shqiptarë.<sup>44</sup> Deri tanë, duket se pak iniciativa janë ndërmarrë me qëllim që të rrisin përfaqësimin e minoriteteve në shërbimet publike, ushtri ose gjyqësor; megjithatë, autoritetet shqiptare kanë bërë të ditur se fushatat e rritjes së ndërgjegjësimit për ta rritur interesimin në mundësitet e punësimit në polici, dhe në përgjithësi, në sektorin e shërbimit publik do të mund ta ndihmonin rritjen e përfaqësimit të romëve në këto fusha.
125. ECRI rekomandon që autoritetet shqiptare të shtojnë përpjekjet e tyre për të rritur përfaqësimin e grupeve të minoritetit aktualisht të përfaqësuar pak në institucionet shtetërore. Këto përpjekje duhet të synojnë rritjen e interesimit në mundësitet e punësimit brenda këtyre institucioneve; ECRI, gjithashtu, fton autoritetet shqiptare që të konsiderojnë mundësinë e marrjes së veprimeve pozitive në këtë fushë.

<sup>43</sup> Shih lartë, Ekzistenza imi dhe Implementimi i Dispozitave Ligjore- Dispozitat e ligjit Zgjedhor.

<sup>44</sup> Raporti I Progresit mbi Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Komunitetit Romë, fq. 64

## Konsultimet dhe përfshirja e personave të cilët i takojnë grupeve minoritare

126. Në reportin e tretë, ECRI ka bërë një varg rekomandimesh të cilat kanë synuar që segmentet e ndryshme dhe interesat brenda grupeve minoritare janë konsultuar dhe janë të aftë të marrin pjesë në vendimmarrje në nivel kombëtar dhe vendor.
127. Përsa i përkët konsultimeve dhe pjesëmarrjes në nivel kombëtar, ECRI i referohet analizës së vet të situatës më herët në këtë raport.<sup>45</sup> Nën Strategjinë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Komunitetit Romë, janë bërë përpjekje për t'i përforuar kapacitetet e organizatave bazë të romëve në lidhje me përfaqësimin e interesave të komunitetit të tyre dhe menaxhim të programit; organizatat rome janë përfshirë gjithashtu edhe në përgatitjen e Strategjisë për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Komunitetit Romë, në përgjithësi përmes konsultimeve dhe proceseve të diskutimeve. ECRI vëren me keqardhje se me gjithë këto përpjekje, organizatat rome ende konsiderojnë se propozimet e tyre nuk janë marrë parasysh sa duhet, se priorititet e autoriteteteve vendore nuk i përfillin nevojat e komunitetit romë dhe se ata janë të përjashtuar nga procesi i vendimmarrjes; vendimet e marra janë ende të pakuptueshme për organizatat rome. ECRI nënizon se dialogu duhet të forcohet më tej në të gjitha nivelet e vendimmarrjes; edhe pse është qartësisht e jo e mundur që të plotësohen të gjitha dëshirat e komuniteteve gjithë kohën, rritja e mundësive të tyre për të ndikuar në vendime mund ta përmirësojë cilësinë e këtyre vendimeve dhe perspektivën e arritjes te zgjidhjet të pranuara për të gjithë të interesuarit.
128. ECRI inkurajon autoritetet shqiptare që të vazhdojnë përpjekjet e tyre me synim forcimin e kapaciteteve të organizatave rome dhe menaxhimin e programit.
129. ECRI rekomandon që autoritetet shqiptare të forcojnë dialogun e tyre me komunitetet rome dhe egjiptiane për të siguruar dhënien e një konsiderate më të madhe për shqetësimet e tyre në të gjitha nivelet.
130. ECRI rekomandon sërisht që autoritetet shqiptare të inkurajojnë dhe përkrahin përfshirjen e grupeve minoritare dhe organizatave bazë në zhvillimin, zbatimin dhe vlerësimin e projekteve dhe masave të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë tek ta.

## VIII. Trafikimi i Fëmijëve Romë dhe Egjiptian

131. Në reportin e tretë, ECRI i ka rekomanduar autoriteteteve shqiptare që të vazhdojnë dhe përforcojnë përpjekjet e tyre në luftimin e trafikimit të fëmijëve në nivel kombëtar dhe vendor, dhe që të vendosin një strukturë për koordinimin e këtyre përpjekjeve. Ai ka theksuar nevojën për t'i kushtuar vëmendje dhe burime të mjaftueshme rritjes së vetëdijes, parandalimit, kthimit të fëmijëve të zhdukur, mbrojtjes dhe kujdesit ndaj viktimate pas kthimit, si dhe re-integrimit. ECRI ka rekomanduar fuqimisht që përfaqësuesit e komuniteteve rome dhe egjiptiane të përfshihen drejtpërdrejtë në zhvillimin dhe zbatimin e masave të tillë.
132. ECRI mbetet thellësish i shqetësuar në lidhje me fenomenin e trafikimit të fëmijëve shqiptarë për shkak të shfrytëzimit të tyre, të cilin e ka përshkruar në reportin e vet të tretë për Shqipërinë dhe ku një numër disproporcional i viktimate janë fëmijë romë dhe egjiptianë. ECRI përmend me interes se që nga rapporti i tretë, Shqipëria ka nënshkruar dhe ratifikuar Konventën e Këshillit të Evropës mbi Veprimet kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, i cila ka hyrë në fuqi me 1 shkurt 2008. Autoritetet po ashtu kanë përforuar dispozitat e ligjit penal kundër trafikimit dhe kanë marrë masa për të ofruar një mbrojtje të shtuar

<sup>45</sup>Shih lartë, Organet dhe institucionet anti-diskriminim- Komiteti Shtetëror për Minoritete

për viktimat. Megjithatë, autoritetet vendore dhe shërbimet sociale janë akoma shumë pak të përfshira në këto përpjekje, dhe fëmijët mbesin të rrezikuar ndaj fenomenit të shfrytëzimit dhe trafikimit. Kjo aplikohet në veçanti për ata të cilët nuk e vijojnë shkollën, janë analfabetë dhe nuk kanë dokumente identifikimi, një situatë e cila në mënyrë disproporcionale i prek egjiptianët, dhe mbi të gjithë, Romët.

- 133. ECRI i inkurajon autoritetet shqiptare që të vazhdojnë dhe përforcojnë përpjekjet përluftimin e trafikimit të fëmijëve. Ai fuqimisht rekomandon që autoritetet të përfshijnë drejtësuaritë përfaqësuesit e komunitet egjiptian dhe rom në zhvillimin dhe zbatimin e këtyre masave që synojnë luftimin e trafikimit të fëmijëve të tyre në mënyrë që të zhvillojnë informime efektive dhe iniciativa përritjen e vetëdijes si dhe të mendojnë masa efektive parandaluese.
- 134. ECRI u rekomandon fuqimisht autoriteteteve shqiptare rritjen e vetëdijes në mesin e zyrtarëve publikë vendorë dhe shërbimeve sociale përkatëse në lidhje me përgjegjësitë e tyre në këtë fushë, të sigurojnë se ata kanë burime të mjaftueshme përluftim e përgjegjësive të tyre në mënyrë efektive dhe t'i pajisin ata me trajnime që synojnë përgatitjen e tyre përmarrjen përsipër të këtyre përgjegjësive.

## **IX. Sjellja e Zyrtarëve për Zbatimin e Ligjit**

- 135. Në raportin e tretë, ECRI ka bërë një numër rekomandimesh në lidhje me sjelljen e zyrtarëve përzbatimin e ligjit, në veçanti në lidhje me atë se të gjitha deklarimet për keqtrajtim nga policia e anëtarëve të grupeve minoritare duhet të hetohen me kujdes nga një organ i pavarur. Ai ka nënvizuar se deklarimet për keqtrajtime nga policia të cilat paraqiten në gjykatë duhet të merren parasysh shpejt dhe me kujdes, dhe shkelësit duhet të dënohen ashtu si duhet. Gjithashtu, ai ka rekomanduar që autoritetet shqiptare të sigurojnë se trajnimet përluftim e përfshihen në trajnimin fillostar dhe trajnimin vazhdues që zbatohen përluftim.
- 136. Autoritetet shqiptare kanë bërë të ditur se reforma të rëndësishme të trajnimit të policëve janë zbatuar. Që nga viti 2005, rekrutëve të rinj u është dashur të kalojnë 22 javë të trajnimit teorik, i cili në mënyrë të detyrueshme përfshin pyetje të etikës, larmishmëria dhe respektimi i të drejtave të njeriut, jo më pak në lidhje me luftimin e diskriminimit, të pasuar nga 22 javë të trajnimit praktik, gjatë së cilës vlerësohet se si njohuritë teorike të tyre vihen në praktikë.
- 137. ECRI veren se 10 për qind e ankesave të paraqitura në Zyrën e Avokatit të Popullit kanë të bëjnë me polisinë dhe të gjitha ankesat në lidhje me sjelljen e polisë trajtohen me kujdes nga Avokati i Popullit.<sup>46</sup> Gjithashtu, ai verën se, gjatë vizitës së delegacionit të tij në vitin 2008, Komiteti i Këshillit të Evropës përluftim e Torturës dhe Trajtimin Çnjerëzor dhe Degradues (KPT) ka konstatuar një numër përmirësimesh të dukshme, edhe pse, përsa i përket keqtrajtimit nga policia, treguesi në këtë fazë ka qenë thjeshtë që tendenca e përgjithshme ka sugjeruar fillimin e një përmirësimi.<sup>47</sup>
- 138. ECRI mirëpret këta hapa pozitivë, por shpreh keqardhje, që nuk ka mbledhje të dhënave përluftim të cilët vijnë në kontakt me polisinë, të analizuar sipas origjinës së tyre etnike ose kombëtare, fesë, gjuhës, kombësisë, është e pamundur të vlerësohet se si masat e ndërmarra ndikojnë tek grupet e

<sup>46</sup> 274 nga 2,792 ankesa të prcesuara në vitin 2007; 215 nga 2,555 në vitin 2006; shih raportet vjetore të aktivitatit të Avokatit të Popullit

<sup>47</sup> KPT/Inf(2009)6

ndryshme. Gjithashtu, ai shpreh keqardhje që nuk është bërë progres në drejtim të prezantimit të një sistemi që garanton se të gjitha kallëzimet e keqtrajtimit nga policia do t'i nënshtronen një hetimi të kujdeshëm nga një organ i pavarur. Ai thekson se anëtarët e grupeve minoritare shpesh hezitojnë të paraqesin ankesa kundër zyrtarëve për zbatimin e ligjit, në lidhje me këtë, tërheq vëmendjen në mungesën e besimit tek sistemi gjyqësor dhe policia në mesin e romëve, siç është përmendur në raportin e progresit që e vlerëson zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Komunitetit Romë.<sup>48</sup> Sipas mendimit të disa anëtarëve të grupeve minoritare kjo mungesë e besimit mund të jetë gjithashtu rezultat, i praktikave korruptive të disa nëpunësve civilë.

- 139. ECRI rekomandon që autoritetet shqiptare të sigurojnë se të gjitha ankesat në lidhje me keqtrajtimin nga policia të anëtarëve të grupeve minoritare të hetohen me kujdes nga një organ i pavarur i policisë dhe autoriteteve të prokurorisë, dhe se kryesit e veprave penale të sillen para drejtësisë. Ai thekson se ankesat e tillë duhet të trajtohen sa më shpejt dhe me kujdesin më të madh që është e mundur, dhe që shkelësit të dënohen proporcionalisht, në mënyrë që të përcillet mesazhi tek shoqëria se një sjellje e tillë nga ana e policisë nuk tolerohet dhe do të dënohet. Ai e tërheq vëmendjen e autoriteteve të Rekomandimi i tij Nr. 11 i Politikave të Përgjithshme mbi luftimin e racizmit dhe diskriminimit racial në policim.
- 140. ECRI inkurajon fuqimisht autoritetet shqiptare të rrisin përpjekjet e tyre për të siguruar trajnime për të drejta e njeriut dhe respektimin e larmishmërisë në shoqëri si pjesë e trajnimin fillestare për të gjithë oficerët e policisë, dhe se trajnimet e tillë të përfshijnë informacione mbi racizmin dhe diskriminimin dhe legjislacionin e zbatueshëm në këtë çështje. Gjithashtu, ai rekomandon që autoritetet të sigurojnë që këto çështje të trajtohen si pjesë e trajnimit vazhdues të oficerëve të policisë.

## X. Monitorimi i Racizmit dhe Diskriminimi Racial

- 141. Në raportin e tretë, ECRI ka rekomanduar që autoritetet shqiptare, së pari, të bëjnë një regjistrim kombëtar të popullsisë që përfshinë pyetjen në lidhje me origjinën etnike, dhe së dyti, të vendosin një sistem monitorues që mundëson mbledhjen e informacioneve në lidhje me situatën e grupeve të ndryshme minoritare, një vlerësim të shkallës dhe shkaqeve të diskriminimit dhe vlerësimin e masave për luftimin e tij. Ai ka theksuar në këtë kontekst nevojën për t'i kushtuar rëndësi respektimit të parimeve të konfidencialitetit dhe vetidentifikimit vullnetar.
- 142. Për shkaqe të ndryshme historike, asnjë pyetje në lidhje me prejardhjen etnike nuk ishte përfshirë në regjistrimin e fundit të popullsisë të zhvilluar në vitin 2001. Prandaj, statistikat më të reja zyrtare datojnë nga regjistrimin paraprak i kryer në vitin 1989 dhe përbajnjë tregues të sakta vetëm në lidhje me minoritetet greke, maqedonase, serbo-malazeze dhe vllah/arumunë. Përveç kësaj, edhe saktësia e këtij informacioni është kontestuar fuqimisht nga disa përfaqësues të këtyre minoritetave. Nuk ka ndonjë të dhënë të mbledhur mbi mundësitë e të drejtave nga grupe të ndryshme minoritare të cilët ekzistojnë brenda vendit. Si pasojë, autoritetet nuk kanë ndonjë informacion të saktë në lidhje me situatën e këtyre minoritetave dhe është e vështirë për ta që të marrin masa që synojnë përmirësimin e situatës së disa grupeve dhe të monitorojnë efektshmërinë e veprimeve të ndërmarrë.

<sup>48</sup> Shih Raportin e Progresit mbi Implementimin e Strategjisë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Komunitetit Romë, fq. 63.

143. ECRI është i vetëdijshëm se mbledhja e të dhënave etnike është një çështje e ndjeshme. ECRI nënizon se përbledhja e statistikave etnike për t'i identifikuar më mirë problemet e diskriminimit direkt dhe jo direkt racial dhe për të skicuar zgjidhje të duhura për to, është e vlefshme, nëse përbledhjen edhe disa rregulla qenësore, të dhënat e mbledhura duhet të janë anonime, konfidenciale, të shfrytëzohen vetëm për qëllime për të cilat janë mbledhur dhe të mbledhjen mbi baza të vetidentifikimit vullnetar.
144. ECRI rekomandon përsëri që autoritetet shqiptare të kryejnë një regjistrim kombëtar të popullsisë që përfshin pyetjen në lidhje me identitetin etnik, duke e respektuar parimin e konfidencialitetit dhe vetidentifikimit vullnetar; ECRI fuqimisht rekomandon përfshirjen e përfaqësuesve të grupeve të minoriteteve etnike në fazë të ndryshme të këtij procesi.
145. ECRI rikujton rekomandimin e vet që autoritetet shqiptare të vendosin një sistem të kompletuar, modern për mbledhjen e të dhënave që mundësojnë vlerësimin e situatës së grupeve të ndryshme minoritare në Shqipëri dhe një vlerësim të shkallës së diskriminimit direkt dhe jodirekt. Në lidhje me këtë, ai rekomandon që autoritetet të parashohin mbledhjen e të dhënave të zbërthyera sipas kategorive siç janë kombësia ose prejardhja etnike, feja, gjuha dhe shtetësia në mënyrë që t'i identifikojnë shprehjen e diskriminimit, duke siguruar se mbledhja e të dhënave të tillë bëhet në të gjitha raste në përputhje me parimet e konfidencialitetit, me marrjen e pëlgimit dhe të vetidentifikimit vullnetar të personave që i takojnë një grupi të veçantë. Ky sistem duhet të skicohet në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë aktorët përkatës, përfshirë organizatat e shoqërisë civile. Gjithashtu, duhet të merret parasysh ekzistanca e mundshme e rasteve të diskriminimit të dyfishtë ose të shumëfishtë.

## **REKOMANDIMET QË DO TË NDIQEN ME PËRPARËSI**

Tre rekomandimet specifike për të cilat ECRI kërkon zbatimin me përparësi nga autoritetet shqiptare janë si vijojnë:

- ECRI përsërit rekomandimin e tij që autoritetet shqiptare të forcojnë edhe më shumë kuadrin ligjor në fushën e së drejtës civile dhe administrative, nëprimit futjes së legjislacionit të plotë që synon luftën kundër diskriminimit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë në fushat kryesore të jetës. Për këtë qëllim, ai i referohet Rekomandimit Nr. 7 të Politikës së Përgjithshme mbi legjislacionin kombëtar për luftën kundër racizmit dhe diskriminimit racial.
- ECRI fuqimisht rekomandon që autoritetet shqiptare të vazhdojnë përpara me zbatimin e masave konkrete, në konsultim me komunitetet e ineteresuar, të sigurojë që çdo familje rome të ketë mundësinë e një strehimi të mirë, duke përfshirë lidhjen e marrëveshjes me romët që të kenë mundësi në rrjetin e energjisë elekrike, ujit të pijshëm, kanalizimit dhe rrjetet rrugore. Ai rekomandon që autoritetet t'i rregullojnë qartazi synimet dhe grupet që synojnë në këtë drejtim, për të paktën dy vitet e ardhshme dhe të publikojnë raporte të rregullta mbi progresin e bërë.
- ECRI rekomandon që autoritetet shqiptare, ta pëershpejtojnë krijimin dhe mbështetjen mjediseve për funksionimin e sistemit parashkollor që tu mundësojë fëmijëve romë përmirësimin e aftëssië së tyre në gjuhën shqipe para se të hyjnë në shkollën fillore; gjithashtu, ai i bën thirrje autoriteteteve shqiptare që të përkrahin zbatimin e iniciativave joqeveritare të cilat kanë dhënë rezultate të mira në këtë fushë.

Një proces i ndjekjes ndërkohë të këtyre tre rekomandimeve do të bëhet nga ECRI jo më vonë se dy vite pas publikimit të këtij rapporti.



## **Bibliografia**

Kjo bibliografi i rendit burimet e publikuara të përdorura gjatë ekzaminimit të situatës në Shqipëri. Nuk duhet të konsiderohet si një listë gjithëpërfshirëse e të gjitha informacioneve të ofruara ECRI-s gjatë përgatitjes së këtij reporti.

### **European Commission against Racism and Intolerance (ECRI)**

1. Third report on Albania, 14 June 2005, CRI(2005)23
2. Second report on Albania, 3 April 2001, CRI(2001)2
3. Report on Albania, 9 November 1999, CRI(99)48
4. General Policy Recommendation No. 1: Combating racism, xenophobia, antisemitism and intolerance, October 1996, CRI(96)43
5. General Policy Recommendation No. 2: Specialised bodies to combat racism, xenophobia, antisemitism and intolerance at national level, June 1997, CRI(97)36
6. General Policy Recommendation No. 3: Combating racism and intolerance against Roma/Gypsies, March 1998, CRI(98)29
7. General Policy Recommendation No. 4: National surveys on the experience and perception of discrimination and racism from the point of view of potential victims, March 1998, CRI(98)30
8. General Policy Recommendation No. 5: Combating intolerance and discrimination against Muslims, April 2000, CRI(2000)21
9. General Policy Recommendation No. 6: Combating the dissemination of racist, xenophobic and antisemitic material via the Internet, December 2000, CRI(2001)1
10. General Policy Recommendation No. 7: National legislation to combat racism and racial discrimination, December 2002, CRI(2003)8
11. General Policy Recommendation No. 8: Combating racism while fighting terrorism, March 2004, CRI(2004)26
12. ECRI General Policy Recommendation No. 9: The fight against antisemitism, June 2004, CRI(2004)37
13. General Policy Recommendation No. 10: Combating racism and racial discrimination in and through school education, December 2006, CRI(2007)6
14. General Policy Recommendation No. 11: Combating racism and racial discrimination in policing, June 2007, CRI(2007)39
15. General Policy Recommendation No. 12: Combating racism and racial discrimination in the field of sport, December 2008, CRI(2008)48

### **Other sources**

16. People's Advocate (Ombudsman), Annual Report on the activity of the People's Advocate, 1 January – 31 December 2007, Tirana, 2008
17. People's Advocate (Ombudsman), Annual Report on the activity of the People's Advocate, 1 January – 31 December 2006, Tirana, 2007
18. People's Advocate (Ombudsman), Annual Report on the activity of the People's Advocate, 1 January – 31 December 2005, Tirana, 2006
19. Ministry of Labour, Social Affairs and Equal Opportunities, Progress Report on the National Strategy "on Improving the Living Conditions of the Roma Community", Tirana, December 2007
20. National Strategy for Improving Roma living conditions, Tirana, September 2003
21. Parliamentary Assembly of the Council of Europe, Resolution 1538 (2007), Honouring of obligations and commitments by Albania, adopted by the Assembly on 25 January 2007
22. Parliamentary Assembly of the Council of Europe, Honouring of obligations and commitments by Albania, doc. 11115, report of Committee on the Honouring of Obligations and Commitments by Member States of the Council of Europe (Monitoring Committee), co-rapporteurs: Messrs Platvoet et Wilshire.

23. Commissioner for Human Rights, Report by the Commissioner for Human Rights, Mr Thomas Hammarberg, on his visit to Albania, 27 October – 2 November 2007, CommDH(2008)8
24. Commissioner for Human Rights, « Viewpoint: Forced evictions of Roma families must stop », 4 September 2006
25. Advisory Committee on the Framework Convention for the Protection of National Minorities, Second report submitted by Albania pursuant to Article 25, paragraph 1 of the Framework Convention for the Protection of National Minorities, 18 May 2007, ACFC/SR/II(2007)004
26. Advisory Committee on the Framework Convention for the Protection of National Minorities, Second Opinion on Albania, ACFC/OP/II(2008)003, adopted on 29 May 2008
27. Advisory Committee on the Framework Convention for the Protection of National Minorities, Comments of the Government of Albania on the Second Opinion on Albania, 1 December 2008, GVT/COM/II(2008)005
28. European Committee of Social Rights, Conclusions 2008 (Albania)
29. European Commission for Democracy through Law (Venice Commission), Joint Opinion on the Electoral Code of the Republic of Albania adopted by the Venice Commission at its 78<sup>th</sup> plenary session (Venice, 13-14 March 2009), CDL-AD(2009)005
30. European Commission for the Efficiency of Justice (CEPEJ), European Judicial Systems, 2008 edition (data 2006): Efficiency and quality of justice
31. European Council, 2006/54/EC : Council Decision of 30 January 2006 on the principles, priorities and conditions contained in the European Partnership With Albania and repealing Decision 2004/519/EC
32. European Commission, Albania 2008 Progress Report, {COM(2008) 674}, Brussels, November 2008
33. UNDP, Human Development Report 2007/2008, Albania
34. UNICEF, Breaking the Cycle of Exclusion: Roma Children in South East Europe, Belgrade, 2007
35. De Soto, Beddies and Gedeshi, Roma and Egyptians in Albania: from social exclusion to social inclusion, World Bank Working Paper No. 53, Washington, March 2005
36. Albanian Helsinki Committee, Research on Minorities' Policies and Funding Strategies in Albania, Tirana 2007
37. Human Development Center, Educational Situation of Roma Children in Albania, Tirana, 2007
38. US Department of State, Country Reports on Human Rights Practices, 2008 – Albania – released by the Bureau of Democracy, Human Rights and Labour, 25 February 2009
39. US Department of State, International Religious Freedom Report 2008 – Albania – released by the Bureau of Democracy, Human Rights and Labour, September 2008
40. US Department of State, Trafficking in Persons Report, 2008

## **SHTOJCË : KENDVESHTRIMI I QEVERISE**

### **Shtojca në vijim nuk përbën pjesë të analizës dhe propozimeve të ECRI në lidhje me situatën në Shqipëri**

Ne perputhje me proceduren nga vendi ne vend, ECRI ndermori një dialog konfidencial me autoritetet shqiptare lidhur me variantin e pare te raportit. Nje numer komentesh te autoriteteteve jane marre ne konsiderate dhe jane perfshire ne report (i cili sipas praktikes se ECRI merr parasysh vetem zhvillimet para dates 3 korrik 2009, qe eshte data a variantit te pare te raportit).

Autoritetet kane kerkuar qe kendveshtrimi qe vijon te perfshihet ne shtojcen e raportit te ECRI.



## **Komentet e Qeverisë Shqiptare mbi Raportin e 4<sup>rt</sup> të ECRI-t mbi Shqipërinë**

Qeveria e Republikës së Shqipërisë shpreh vlerësimin e saj për angazhimin e kahershëm të Komisionit Europian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) për forcimin e të drejtave të njeriut dhe për luftën kundër diskriminimit dhe intolerancës në Europë.

Qeveria Shqiptare riafirmon zotimin e saj për të zhvilluar një kuadër ligjor dhe institucional që krijon mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët, që mbështet diversitetin kulturor, etnik dhe gjuhësor, që përkrah zhvillimin politik dhe ekonomik gjithëpërfshirës – si edhe që mbron të drejtat e njeriut në kontekstin e imigracionit të paligjshëm dhe azilit.

Duke konsideruar Raportin e 4<sup>rt</sup> të ECRI-t mbi Shqipërinë si një dokument të rëndësishëm, i cili jep një pamje të përgjithshme dhe një analizë të situatës së pakicave në vend, si edhe që propozon një sërë rekomandimesh dhe treguesish për luftën kundër racizmit dhe diskriminimit, Qeveria Shqiptare paraqet specifikimet e mëposhtme me qëllim krijimin e një konteksti sa më të plotë mbi mekanizmat institucionalë, politikat strategjike dhe iniciativat e ndërmarra në kuadër të angazhimeve për të luftuar fenomene të diskriminimit dhe për të promovuar tolerancën shoqërore.

### **Instrumentat juridike ndërkombëtare**

Autoritetet shqiptare vlerësojnë theksin e vënë nga ECRI mbi progresin e arritur në fushën e të drejtave të njeriut dhe ligjit ndërkombëtar, përfshirë këtu ratifikimin e Protokollit Nr.12 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, Protokollit Shtesë të Konventës mbi Krimin Kibernetik, Konventën Europiane për Pjesëmarrjen e të Huajve në Jetën Publike në Nivel Lokal, si edhe Konventën Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Gjithë Punëtorëve Emigrantë dhe Pjesëtarëve të Familjeve të Tyre.

Në lidhje me rekomandimin e ECRI-t mbi Nenin 14 të Konventës Ndërkombëtare për Eleminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial, Qeveria Shqiptare konfirmon angazhimin e saj për të nisur procesin e pranimit të Deklaratës për njohjen e kompetencave të Komitetit për Eleminimin e Diskriminimit Racial (CERD).

Qeveria Shqiptare rikonfirmon qëndrimin e vet mbi Kartën Europiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare. Garancitë kushtetuese për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të minoriteteve, si edhe instrumentat ligjore ndërkombëtare në të cilat Shqipëria është palë (përfshirë këtu edhe Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare) sigurojnë mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe gjuhësore të komuniteteve minoritare në vend. Në mungesë të kërkesave zyrtare për aderimin në Kartën Europiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare, si edhe duke konsideruar barrën financiare dhe administrative që lidhet me miratimin e këtij instrumenti ligjor, Qeveria Shqiptare ripërsërit angazhimin e vet të plotë për të mbështetur mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të pakicave përmes zbatimit të gamës së gjerë të legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

## **Dispozita kushtetuese dhe dispozita të tjera themelore**

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë bazohet në parimin themelor të barazisë së qytetarëve, i cili siguron mbrojtjen e të drejtave sociale, kulturore, ekonomike dhe politike të pakicave, si edhe mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të gjinisë, racës, gjuhës, përkatësisë etnike apo besimit fetar. Megjithatë Qeveria Shqiptare njeh nevojën për të mbështetur procesin e konsolidimit të kuadrit ligjor për mbrojtjen e pakicave dhe grupeve vulnerabël, si edhe plotësimit të parimeve kushtetuese me legjislacionin dytësor përkatës.

Në lidhje me rekomandimin e ECRI-t mbi miratimin e një ligji të përgjithshëm kundra diskriminimit, Qeveria Shqiptare nënizon se Parlamenti Shqiptar së fundmi ka miratuar ligjin anti-diskriminim, bazuar në nismën ligjore të aktorëve nga shoqëria civile.

### **Dispozita të ligjit zgjedhor**

Qeveria Shqiptare mirëpret vlerësimet e ECRI-t në drejtim të reformës elektorale, përfshirë këtu modernizimin e infrastrukturës zgjedhore përmes krijimit të bazës dixhitale të dhënave të Rregjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile dhe futjen e dokumentave biometrike të identitetit. Reformat e ndërmarra në këtë kontekst përbëjnë gjithashtu edhe masa të rëndësishme në përbushje të kërkesave bazë për liberalizimin e vizave, në përputhje me marrëveshjen e Shqipërisë me Komisionin European të firmosur në qershor 2008.

Në lidhje me çështjen e modaliteteve për shpërndarjen e kartave të reja të identitetit, vlen për t'u theksuar se, në kuadër të zgjedhjeve të përgjithshme më 28 qershor 2009, Qeveria Shqiptare mori përsipër pjesën më të madhe të kostove për grupet e dizantazhuara, si edhe kostot e plota për komunitetin Rom. Gjithashtu ka rëndësi të vihet në dukje se çështja e përjashtimit nga e drejta themelore politike e të votuarit, për shkak të pamundësisë për t'u pajisur me dokumentat biometrikë të identitetit për arësyen financiare, nuk është ngritur as në kontekstin pas-zgjedhor, as edhe në vijimësi.

Për sa i përket komenteve të raportit të ECRI-t mbi dispozitat ligjore të cilat përcaktojnë të drejtat e pakicave për t'u organizuar dhe përfaqësuar politikisht, Qeveria Shqiptare dëshiron të theksojë se legjislacioni shqiptar lejon krijimin e subjekteve politike të cilat fokusohen në mbrojtjen dhe zhvillimin e të drejtave të njeriut dhe të interesave të pakicave. Gjithashtu, vlen për t'u vënë në pah fakti se parti politike të grupeve minoritare kanë luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimet politike pas vitit 1990, dhe kanë qenë pjesë e strukturave qeverisëse në nivele të larta dhe ministrore.

Në lidhje me sugjerimet për caktimin në Parlamentin Shqiptar të një kuote të cilësuar për përfaqësues të pakicave, Qeveria Shqiptare vë në dukje faktin se nuk ekziston asnje standard ndërkombëtar që kërkon përbushjen e parimit të përfaqësimit të minoriteteve përmes vendosjes së kuotave parlamentare përkatëse. Ndërkohë që rritja e përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së pakicave përbën një çështje prioritare, qëndrimi i Qeverisë Shqiptare mbështetet në një përqasje të orientuar kah procesi që sjell forcimin e përfshirjes së pakicave në jetën politike të vendit, sesa nga prezumimi i zgjidhjes së kësaj problematike përmes rezervimit të vendeve në institucionet legislative kombëtare. Në këtë kontekst, Qeveria Shqiptare

rikonfirmon angazhimin e saj për të mbështetur përfshirjen efektive të grupeve minoritare në nivel lokal dhe kombëtar, përmes përmirësimit të kornizave institucionale në bazë të eksperiencës të akumuluar derimëtani, si edhe të praktikave të ndryshme të vendeve të tjera.

### **Komiteti Shtetëror për Minoritetet**

Në lidhje me komentet e ECRI-t mbi çështjen e përfaqësimit të pakicave në përbërjen e burimeve njerëzore të Komitetit Shtetëror për Minoritetet, ka rëndësi të theksohet se termat e referencës për përzgjedhjen e stafit të këtij institucioni përcaktojnë zhvillimin e konsultimeve të ngushta me organizata të shoqërisë civile të cilat përfaqësojnë drejtpërsëdrejti grupet e ndryshme minoritare. Gjithashtu, kandidaturat e paraqitura për miratim në Këshillin e Ministrave përcaktohen nga një shumësi faktorësh, të cilët përfshijnë përkatësinë minoritare të kandidatëve potencialë, nivelin e arsimimit dhe aftësitë profesionale, profilin e aktivizmit civil në fushat e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të pakicave, si edhe nivelin e popullaritetit të tyre tek grupet minoritare përkatëse.

Për sa i përket pakicave të cilat nuk gjëzojnë statusin e minoriteteve kombëtare apo etno-linguistike, Qeveria Shqiptare dëshiron të nënvojë se çështja e njohjes së statusit të minoritetit kombëtar për komunitetin Boshnjak është nën shqyrtim. Ndërkaq, Qeveria Shqiptare ripërsërit pozicionin e saj mbi çështjen e komunitetit Egypitan, duke theksuar se mungesa e gjuhës apo e shtetit amë e pamundëson njohjen e statusit të minoritetit kombëtar apo etno-linguistik për këtë pakicë. Në këtë kuadër, vlen për t'u theksuar se Komiteti Shtetëror për Minoritetet është i mandatuar për mbrojtjen e interesave dhe trajtimin e shqetësimeve të komuniteteve të lartpërmendura, deri në zgjidhjen e çështjeve lidhur me njohjen e statusit përkatës.

### **Strehimi**

Qeveria Shqiptare dëshiron të theksojë se institucionet e linjës kanë ndërmarrë të gjitha masat priorituese në përputhje me kornizën e Strategjisë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetës së Komunitetit Rom. Me përfundimin e vlerësimit të nevojave për strehim për minoritetin Rom, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve është angazhuar për zhvillimin e një studimi fizibiliteti për përcaktimin e synimeve strategjike afat-mesme dhe afat-gjata në drejtim të sigurimit të burimeve financiare për projektet rehabilitues, si edhe për ravijëzimin e kuadrit bashkëpunues mes institacioneve të qeverisjes qëndrore, autoritetet lokale dhe organizatave të shoqërisë civile të komunitetit Rom.

Në lidhje me sugjerimet e ECRI-t në drejtim të përmirësimit të kushteve të jetësës për grupet e marginalizuara përmes caktimit të masave detyruese për autoritetet lokale, Qeveria Shqiptare rikonfirmon qëndrimin e saj në mbështetje të një përqasjeje të bazuar tek incentivat pozitive – permes alokimit të financimeve për projektet e rehabilitimit sipas një skeme konkurrimi përfitimin e granteve, e cila lejon përdorimin më eficient të fondeve në dispozicion, si edhe promovon forcimin e kapaciteteve përkërkimin e granteve dhe planifikimin e projekteve nga institucionet vendore.

## Arsimimi

Përballë sfidës për rritjen e pjesëmarrjes së fëmijëve Romë në të gjitha nivelet e sistemit të edukimit, angazhimi i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës është fokusuar në drejtimet vijuese: rregjistrimin në shkollë të fëmijëve Romë të cilët nuk janë të pajisur me certifikatë lindjeje dhe sigurimin e shërbimeve shëndetësore të vaksinimit falas për ta, mbështetjen e projektit "Shansi i Dytë" për fëmijët Romë dhe të rinjtë të cilët rinisin studimet e tyre akademike, rindërtimin e shkollave me frekuentim të lartë nga fëmijë Romë dhe në zonat ku komuniteti Rom përbën shumicën e banorëve, bashkëpunimin me shoqërinë civile dhe organizatat ndërkombëtare për uljen e varfërisë së komunitetit Rom, si edhe zhvillimin e fushatave ndërgjegjësuese mbi përfitimet që kanë familjet Rome fëmijët e të cilave ndjekin shkollën dhe kanë një nivel më të lartë arsimimi. Në këtë kontekst vlen për t'u theksuar edhe nisma e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për alokimin e bursave të studimit dhe caktimin e kuotave për pranimin e studentëve Romë në programe të aftësimit profesional dhe të sistemit të lartë të edukimit.

Në kuadër të komenteve të ECRI-t mbi domosdoshmërinë e përmirësimit të informacionit statistikor mbi cilat bazohet planifikimi strategjik për promovimin e arsimimit të grupeve të dizavantazhuara, Qeveria Shqiptare thekson se, duke nisur që nga viti 2008, Ministria e Arsimit dhe Shkencës është angazhuar në krijimin e një baze gjithëpërfshirëse të të dhënavë mbi edukimin e fëmijëve Romë, si edhe atyre që u përkasin pakicave të tjera në vend.

## Punësimi dhe integrimi në tregun e punës

Qeveria Shqiptare rikonfirmon angazhimin e saj për të zbutur varfërinë dhe për të luftuar marginalizimin ekonomik të grupeve të disavantazhuara dhe atyre vulnerabël, nëpërmjet konsolidimit të parimeve të barazisë së qytetarëve dhe barazisë së mundësive në kuadrin ligjor, mekanizmat institucionalë, politikat strategjike dhe nismat e ndërmarra nga autoritetet vendase.

Në lidhje me rekomandimin e ECRI-t mbi "veprimin pro-aktiv" në luftën kundër diskriminimit, Qeveria Shqiptare nënvizon faktin se parimet ligjore të barazisë së qytetarëve dhe të mundësive plotësohen nga udhëzime dhe iniciativa institucionale të cilat marrin në konsideratë veçantitë e grupeve të ndryshme vulnerabël. Përkatësisht, angazhimi i autoritetetve qëndrore dhe vendore për promovimin e aksosit të Romëve në skemat kombëtare të punësimit dhe për integrimin e komunitetit Rom në tregun e punës janë bazuar në karakteristikat specifike të kësaj pakice. Në këtë kuadër, autoritetet shqiptare kanë investuar burime të konsiderueshme për zhvillimin e fushatave ndërgjegjësuese me qëllim informimin e komunitetit Rom mbi përfitimet që ata mund të gëzojnë, në kuadër të ndihmës sociale për kategoritë në nevojë të përcaktuara nga legjislacioni shqiptar.

## Strategjia Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Komunitetit Rom

Në rezonancë me komentet e ECRI-t, autoritetet shqiptare vërejnë se procesi i monitorimit të implementimit të Strategjisë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Komunitetit Rom ka një rëndësi të veçantë për vlerësimin e progresit të arrirrë në fusha të ndryshme, në

identifikimin e problematikave të reja dhe sinkronizimin e projekteve dhe nismave të ndërmarra me situatat e ndryshme sociale. Në këtë kontekst, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta ka ndërmarrë përgjegjësinë për bashkërendimin e punës së grupit ndërministror të nivelit të lartë, i cili mbikqyr implementimin e Strategjisë përmes lehtësimit të grumbullimit të të dhënave dhe shkëmbimit të informacionit, si edhe angazhimit të organizmave dhe institucioneve të linjës për përbushjen e objektivave të përcaktuara në dokumentin e Strategjisë.

Angazhimi i Qeverisë Shqiptare për përmirësimin e kushteve dhe standardeve të jetesës për komunitetin Rom u riafirmua përmes Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM 437, 8 Prill 2008) për t’iu bashkuar nismës Dekada e Përfshirjes së Romëve 2005–2015. Në këtë kuadër, Plani Kombëtar i Veprimit përcakton zgjerimin e resurseve në dispozicion të promovimit të mirëqënies së komunitetit Rom, si edhe konsolidimin e praktikave të konsultimit dhe bashkëpunimit mes institucioneve vendore dhe organizatave të shoqërisë civile të cilat përfaqësojnë interesat e kësaj pakice.

### **Policia e Shtetit**

Qeveria Shqiptare vë në dukje se policia e shtetit mbledh dhe administron të dhëna statistikore mbi kriminalitetin në vend duke u bazuar në tipologjinë e akteve kriminale të përcaktuara në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, përfshirë këtu edhe ato të cilat implikojnë racizmin dhe intolerancën (si Neni 73 mbi genocidin, Neni 74 mbi krimet ndaj njerëzimit, Neni 253 mbi shkeljen e barazisë së qytetarëve, Neni 86 dhe Neni 87 mbi torturën, Neni 266 mbi thirrjen për urrejtje, si edhe Neni 265 mbi nxitjen e urrejtjes dhe dhunës etnike). Përkatësisht, numri i vogël i procedimeve penale për raste të dhunës së motivuar nga shkaqe racore përbën një tregues pozitiv përsa i përket qëndrimeve, opinioneve dhe sjelljeve mbizotëruese në shoqërinë shqiptare.

Në vijim të objektivave në kuadrin e Strategjisë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetësës së Komunitetit Rom, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë ka përpunuar udhëzimet përkatëse për strukturat lokale, me qëllim mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të minoritetit Rom, si edhe të komunitetit Egypitan.

Ministria e Brendshme konfirmon se, pamvarësisht mungesës së sjelljes së dhunshme të motivuar nga shkaqe raciale nga punonjës të policisë në detyrë, autoritetet shqiptare janë zotuar për një luftë të pandërpërë ndaj abuzimit verbal apo dhunimit të të drejtave të qytetarëve të dyshuar për veprime kriminale përgjatë procesit të ndalimit dhe hetimit. Në kontekstin e komenteve të ECRI-t në lidhje me kuadrin institucional në shërbim të luftës kundra dhunimit të ligjit nga punonjësit e policisë, Qeveria Shqiptare dëshiron të vëré në dukje se Shërbimi i Brendshëm i Kontrollit pranë Ministrisë së Brendshme ka përgjegjësinë për të klasifikuar çështjet e keqtrajtimit nga ana e nëpunësve të zbatimit të ligjit dhe për t’ia përquar përkatësisht Prokurisë së Përgjithshme.

## Azili dhe imigrimi

Në lidhje me shënimet e ECRI-t mbi çështjen e ndryshimit të stafit, Ministria e Brendshme konfirmon se legjislacioni mbi policinë e shtetit dhe udhëzimet institucionale përkatëse japid përcaktimë të qarta mbi caktimin e stafit të policisë kufitare dhe të migracionit, procedurat e transferimit të punonjësve, si edhe parakushtet për ngritjen në detyrë. Dispozitat në fuqi specifikojnë se, në momentin e caktimit të detyrë pranë Departamentit të Kufirit dhe Migracionit, punonjësit e policisë duhet të kenë kryer programet e posaçme të trajnimit, si edhe duhet të impenjohen për qëndrimin në detyrën e dhënë për një periudhë të paktën tre-vjeçare. Në veçanti, garancitë ligjore dhe administrative nuk lejojnë ndryshime të pajustifikuara të stafit dhe ndërkaq garantojnë që punonjësit e policisë së azilit dhe migracionit të kenë trajnimin dhe kualifikimet e duhura.

Në këtë kontekst, Qeveria Shqiptare thekson se kuadri ligjor për rregullimin e statusit të nepunësit civil është tanimë në pjesën më të madhe i kompletuar, dhe ndërkaq ripërsërit angazhimin e saj për të promovuar forcimin e një administratë publike të bazuar në meritokraci, të depolitizuar dhe të pavarur.

## Përfaqësimi në institucionet shtetërore

Qeveria Shqiptare nën vizon faktin se legjislacioni kombëtar mbi shërbimin civil bazohet në parimin thelbësor të barazisë së mundësive dhe ndërkaq siguron pjesëmarrjen e pakicave në administratën publike, sistemin gjyqësor, forcat e armatosura, si edhe policinë e shtetit. Autoritetet qeverisëse në nivel lokal dhe qëndror mbeten të angazhuara për rritjen e përfaqësimit të pakicave në sektorin publik, përmes zhvillimit të fushatave ndërgjegjësuese, si edhe zbatimit të masave të reja lehtësuese për rekrutimin e personave të cilët kanë përkatësi të ndryshme etnike.

## Monitorimi i situatës

Autoritetet shqiptare konvergojnë me ECRI-n në identifikimin e rëndësisë së veçantë që ka analizimi i plotë i të dhënave statistikore mbi të cilat bazohen reformat legislative dhe politikat e ndërmarra, me qëllim sinkronizimin e nismave qeveritare dhe jo-qeveritare me specifikat e situatave të ndryshme. Në këtë kuadër, autoritetet shqiptare gjykojnë se sfida për arritjen e mirëqeverisjes kërkon dixhitalizimin e gjithë informacionit të akumuluar, integrimin dhe analizimin e të dhënave në dispozicion, si edhe investimin serioz për grumbullimin sistematik të një baze të gjerë të dhëash në të ardhmen.

Në lidhje me rekandimin e ECRI-t për rregjistrimin e përkatësisë etnike në kontekstin e përpunimit të të dhënave statistikore kombëtare, Qeveria Shqiptare vë në dukje se Instituti Kombëtar i Statistikave ka vendosur përfshirjen e pyetjes mbi etnicitetin në rregjistrimin e përgjithshëm të popullsisë që do të ndërmerret në vitin 2011.

\*

\* \* \*

Qeveria Shqiptare rikonfirmon vullnetin e saj për një bashkëpunim transparent dhe të qëndrueshëm me ECRI-n në luftën kundër racizmit dhe diskriminimit, si edhe në mbrotjen e të drejtave dhe zhvillimin e mundësive për minoritetet, komunitetet e disavantazhuara dhe grupet vulnerabël në vend. Në këtë kuadër, Qeveria Shqiptare shpreh dëshirën për të promovuar tolerancën, mirëkuptimin dhe marrëdhëniet tradicionalisht të mira mes shqiptarëve dhe pakicave në vend, si një trashëgimi e çmuar në tërë rajonin e Ballkanit dhe në kontekstin më të gjerë European.



